


MUHAMMED SHERIF



FEMRA

NËN MBROJTJEN E

ISLAMIT



Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshiruesit!

FEMRA NËN MBROJTJEN E ISLAMIT

Lais Lamyā el-Faruqī
Muhamēd Xh. Bahonari
Muhammed Sharif

Botuar nga: SHB “Drita e Jetës”

© Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit.

Përmbajtja

PARATHËNIE.....	4
FEMRA NË SHOQËRINË KUR'ANORE	8
1. POZITA DHE VLERA E BARABARTË E GJINIVE.....	13
A) PËRMBAJTJET FETARE	13
B) DETYRAT ETIKE, DËNIMET DHE SHPËRBLIMET	14
C) ARSIMIMI	15
Ç) TË DREJTAT LIGJORE.....	16
2. MË MIRË SHOQËRI BISEKSUALE SE MONOSEKSUALE .	18
3. VARSHMËRIA RECIPROKE E ANËTARËVE TË SHOQËRISË.....	21
4. FAMILJA E ZGJERUAR.....	22
5. ORGANIZIMI PATRIARKAL I FAMILJES.....	28
SHËNIME:	32
STATUSI I FEMRËS NË ISLAM	35
FEMRA - GJYSMA E TRUPIT TË SHOQËRISË ZGJIDHJA E PROBLEMEVE SOCIALE	35
LOGJIKA E NATYRËS NJERËZORE	38
KUALITETET E LINDURA TË FEMRËS	40
NDIKIMI I NATYRËS NË PËRCAKTIMIN E ROLIT SHOQËROR TË FEMRËS.....	48
FEMRA NË ISLAM	51
ISLAMI DHE TË DREJTAT E FEMRËS	71
NDRYSHIMET E POZITËS LIGJORE TË FEMRËS NË EVROPË	73
ARDHJA E FEMRËS SË LIRË NË VENDET E LINDJES.....	77
RAPORTI MIDIS STRUKTURËS NATYRORE TË FEMRËS DHE	

TË DREJTAVE TË SAJ	78
ROLI I TË MENDIMEVE DHE I EMOCIONEVE.....	80
TË DREJTAT E BARABARTA TË MASHKULLIT DHE FEMRËS NGA PIKËPAMJA ISLAME	82
SHËNIM:	86
FEMRA NË ISLAM KUNDRUALL TRADITËS HEBREJE DHE KRISHTERE - MITI DHE REALITETI	86
GABIMI I EVËS (HAVËS).....	90
TRASHËGIMIA I EVËS.....	92
BIJAT E TURPIT	95
ARSIMIMI I FEMRËS	97
PROSTITUCIONI	98
DËSHMIMI	100
E DREJTA E GRUAS PËR TRASHËGIMI	102
FATI I KEQ I VEJUSHAVE	102
POLIGAMIA	104
TË MBULUARIT ME SHAMI.....	109

PARATHËNIE

Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirbërësit.

“Dhe njëri nga argumentet e Tij është që për ju, nga lloji juaj, krijohen femrat që të gjeni prehje pranë tyre dhe mes jush ka krijuar dashuri dhe mëshirë; këto vërtetë janë mësim për njerëzit të cilët logjikojnë.” (30:21)

Mbi pikëpamjen islame të problemit të femrës është folur shpesh, nganjëherë në mënyrë objektive me të gjitha elementet e së vërtetës, të bazuara në Kur'anin Famëlartë, e nganjëherë edhe me qëllim të keq. Shumë teori të krishtera e kanë pësuar mu në këtë çështje. Për ç'arsye disa janë përpjekur që femrën islame ta prezantojnë si martire, të ngujuar, me shumë rregulla dhe që vuan e izoluar dhe e papërfillur? Një gjë është padyshim e evidente: shumë njerëz kanë frikë nga qëndrimi progresiv islam kur kemi të bëjmë me femrën. Kur'ani Famëlartë e ka shpallur barazinë e mashkullit dhe femrës, gjersa në shumë vende të krishtera kjo çështje është akoma aktuale dhe pret zgjidhje të drejtë:

“Dhe asnjëri prej jush nuk do t'ia zbulojë mundin e tij, as mashkullit as femrës - ju jeni njëri nga tjetri.” (3:195)

Kur'ani femrën e shikon si pjesëtare shembullore dhe nuk bën kurrfarë dallimi mes mashkullit dhe femrës. Roli i saj në shoqëri është i ndershëm, ajo paraqet zemrën e bashkësisë (umetit) islame. Mjafton të theksohet qëndrimi islam se “Xheneti ndodhet nën këmbët e nënës”, për të kuptuar ç'vend me rëndësi Islami i dedikon femrës. Prandaj femra nën mbrojtjen e Islamit është e mbrojtur me dashuri, kujdes dhe respekt. Allahu xh.sh. ia dha

ndjenjën e maternitetit, që me vete sjell patjetër emocionalitetin e butë, shqetësimin, shpirtin e gjerë dhe bujar për të rritur pasardhësit, por edhe për të qenë në gjendje t'i ndihmojë anëtarit të sëmurë të familjes së vet, duke shëruar atë me kujdesin, dhembshurinë dhe gjerësinë e shpirtit. Islami posaqrisht insiston në arsimimin e femrës. Shkenca është imperativ për muslimanët. Kur'ani Famëlartë nga ky obligim nuk e liron as mashkullin as femrën. Duke pasur parasysh rolin e femrës në klanin e rrjetës së pasardhjes është e tepërt të flitet për nevojën e arsimimit të femrës. Vetëm nëna e arsimuar mund të arsimojë, vetëm nëna e edukuar mund të edukojë. Islami kurrë nuk e ka përjashtuar femrën nga aktivitetet e tjera shoqërore. Përkundrazi, në Islamin e hershëm femrat kanë kryer punë shumë me rëndësi, u janë bashkangjitur luftëtarëve të Islamit në fushëbeteja, kanë përgatitur ushqim dhe kanë mjekuar të plagosurit.

Përmbledhja e vështrimeve të cilin e kemi titulluar “Femra nën mbrojtjen e Islamit”, është origjinale. Është e konceptuar në katër pjesë: Femra në Islam kundruall traditës hebreje dhe krishtere - miti dhe realiteti; Femra në shoqërinë kur'anore; Statusi i femrës në Islam; Islami dhe e drejta e femrës. Secila pjesë ka autorin e vet. Edhe përkundër këtij fakti, pjesët e këtyre vështrimeve edhe në rrafshin kompozicional edhe në atë tematik korrespondojnë mjaft mirë dhe fitohet përshtypja se kemi të bëjmë me një tërësi të vetme kompozicionale të formësuar me mjeshtëri. Autorët e këtyre vështrimeve, në mënyrë bindëse, dëshmojnë se Islami nuk ka qenë - drim shtypës ndaj femrës dhe nuk sillet me përçmim ndaj

vlerave të saj. Përkundrazi, ata theksojnë rolin e ndershëm të saj në familje dhe shoqëri. Këto vështrime kemi vendosur t'i botojmë si përmbledhje punimesh të botuara në revistën “Drita e Jetës” në shenjë të respektit dhe të përkujtimit të bijave dhe familjes së Profetit a.s. Ky është shkas plotësues për të theksuar rëndësinë e madhe të nënës, femrës dhe bashkëshortes. Kjo familje e ndershme, e Pejgamberit a.s., është shembull për të gjithë ne besimtarët. Kudo që ka ndodhur, ka sjellë paqe dhe lumturi, ka ndritur me kujdes dhe butësi. Me botimin e këtyre vështrimeve, të cilin e kemi titulluar “Femra nën mbrojtjen e Islamit”, nuk ka mënyrë më të mirë për të përkujtuar personalitetin e tyre fisnik. Ajo paraqet shembull për të gjitha muslimanet se si duhet krijuar rregull dhe harmoni në familje, si do të ndikojnë me sjelljen dhe nderin e tyre në zhvillimin e shoqërisë islame, në respektin dhe nderimin reciprok.

Sot roli i femrës është më delikatë se asnjëherë. Për këtë arsye, literaturë nga kjo fushë kurrë nuk ka mjaft. Sërish smirkëqinjte i janë vërsulur familjes islame, ata dëshirojnë ta zhdukin gjënë më të shenjtë që kemi. Femra duhet të jetë mbështetje dhe mbrojtje për mashkullin në rrëmujën e tërësishme jetësore. Dashuria dhe atmosfera e ngrohtë familjare duhet të jetë kompensim për barrën që mashkulli mmbart në planin e sigurimit ekzistencial të familjes. Të gjithë ata që gjykojnë me mend për jetën e kanë të qartë se Islami ka bërë ndarje të drejtë të punës ndërmjet mashkullit dhe femrës në aspektin e të drejtave dhe detyrave, të cilat janë në harmoni me esencën e jetës, por edhe të natyrës së njeriut.

Pejgamberi a.s. ka deklaruar: “Jeta tokësore është begati, kurse begatia më e madhe është femra e mire.”

Me të vërtetë, qëllimi i këtij publikimi nuk është të mohojë vrazhdësitë ndaj femrës në disa mjedise muslimane. Islami nuk mban kurrfarë përgjegjësie për ata të cilët i kthehen kohës së lashtë të injorancës dhe ushtrojnë ndaj femrës despotizëm e forma të tjera të diskriminimit. Në këtë edicion të revistës “Drita e Jetës” pozita e femrës vështrohet nga pozicioni i Islamit aktiv dhe të pastër, andaj vlera e tij është aq më e madhe, kurse botimi në këtë kohë është i çmueshëm për ata të cilët gjurmojnë të vërtetën dhe burimet e saj të ndritshme.

FEMRA NË SHOQËRINË KUR'ANORE

Tematika e këtij punimi ka dalë nga bindja se shoqëria bashkëkohore vuan nga një numër i madh problemesh serioze dhe sociale lidhur me femrën dhe raportin e ndërsjelltë të dy gjinive në shoqëri. Ndonëse këto probleme, për disa prej nesh, mund të jenë më pak kurse për disa të tjerë më shumë të shprehura, më shqetësuese dhe më lodhëse, ekzistojnë disa regjione, nëse ka regjione të tilla, të botës moderne, qytetarët e të cilave nuk e kanë vërejtur në asnjë mënyrë jehonën e këtyre problemeve. Për këtë arsye ekziston një nevojë e fortë për kërkimin e zgjidhjeve të mundshme. Problemi i femrës në këtë studim tonin është i lidhur me Kur'anin dhe ajo që e kam titulluar *“Shoqëria Kur'anore”* është bërë nga bindja e fortë se Kur'ani ofron propozime më të mira jetësore për reformat bashkë-kohore shoqërore, të cilat mund të gjenden në çfarëdo modeli ose çfarëdo literature.

Mbase shumë prej jush do të çuditëni nga titulli i këtij teksti - *“Femra në shoqërinë Kur'anore”* Ndoshta do të pyesni përse nuk e kam titulluar *“Femra në shoqërinë muslimane”* Më lejoni të sqaroj për çfarë arsye i kam lënë anash shprehjet *“islame”* dhe *“muslimane”* nga titulli i këtij teksti dhe për çfarë arsye e kam zgjedhur këtë titull jo të rëndomtë *“Shoqëria Kur'anore”*.

Ekzistojnë së paku tri shkaqe, për të cilat orientuar në këtë titull. I pari del nga brenga, se shumë bindje dhe veprime janë etiketuar si muslimane dhe islame pa kurrfarë arsye. Ekzistojnë

rreth katërdhjetë kombe në botë pjesëtarët e të cilëve pohojnë se shumicën e popullsisë e kanë muslimane dhe se për këtë arsye janë shoqëri shembullore islame. Kjo, natyrisht, në masë të madhe nxit konfuzion, prandaj shtrohet pyetja: Cili nga këto vende paraqet shoqërinë më të vërtetë dhe më të drejtë islame? Ndër muslimanët mbretëron bindja se shoqëria e tyre kombëtare me siguri është gërshtuar me dëshirën e Allahut Lavdiplotë dhe të Madhëruar.

Nga ana tjetër, jomuslimanët dhe në veçanti, antropologët perëndimorë, shtegtojnë nëpër botë me qëllim të hulumtimit të zakoneve të sjelljes së popujve, duke synuar të trajtojnë çdo variacion brenda botës muslimane si njësoj të vlefshëm. Kjo rezulton me pajtimin e tyre me atë që unë e quaj “teori zoologjike”: shkojnë në teren, incizojnë dhe fotografojnë pamjen e çdo praktike të çuditshme ose ekzotike që dëgjojnë dhe shikojnë dhe për ata ky është Islami dhe praktika islame. Udhëtimi në ndonjë pjesë tjetër të botës islame me mjete të shumta për incizim dhe fotografim ofron brum të kundërt të materialit duke dokumentuar variacionet sipërfaqësore në doke. Kjo, për hulumtuesit e “teorisë zoologjike” ose për etnografët, gjithashtu është Islam ose praktika islame.

Janë bërë shumë pak përpjekje për të kuptuar Islamin si një tërësi. Si rezultat, premisat thelbësore të skepticizmit dhe relativizmit janë rrënjësuar në trurin e hulumtuesit dhe ai kthehet në shtëpi i bindur se nuk ekziston një Islam, por që në botë ekzistojnë rezultate të shumë Islameve. Në këtë stil, hulumtuesi

thekson se ka shumë definicione dhe përshkrime të pozitës dhe rolit të femrës në shoqërinë muslimane. Çdonjëri nga rezultatet e këtyre definicioneve ose përshkrimeve është quajtur “*musliman*” ose “*Islam*”, ndonëse ne si muslimanë mund të konsiderojmë se, në bazë të parimeve dhe bindjeve tona, disa nga këto praktika janë shtrembëruar ose janë prishur për shkak të mashtrimit ose mosinformimit tonë.

Titullin “*Shoqëria Kur'anore*” për këtë shqyrtim e kam zgjedhur pjesërisht edhe për të shpëtuar nga konfuzioni, i cili pason shpjegimet dhe pakuptimësitë. Në këtë mënyrë, shpresoj se do të lëvizin në anën tjetër të vlerës së kufizuar edhe partikula-rizmi i “*teorisë zoologjike*” si dhe hulumtimet që pengohen nga këto mbetje dhe që në planin ideologjik janë në koherencë me rregullat islame. Du- ke pasur parasysh këto çështje aq të rëndësishme për fatin tonë dhe ekzistencën e virtytshme, kurrë nuk duhet të jemi të kënaqur me reportazhe të rastit mbi shtazët e caktuara njerëzore në “*keopshtin zoologjik*”, të cilët janë “*muslimanë*”, statistika dhe doket e të cilëve janë etiketuar si “*isla-me*”. Këto përshkrime janë keqtrajtuar. Nga ana tjetër, “*Kur'anore*” është shprehje e cila është fare e qartë dhe aludon qartë tematikën e këtij punimi.

Emërtimin “*Shoqëria Kur'anore*” e kam zgjedhur si më përshtatës me qëllim që të na orientojë drejt zbulimit të atyre parimeve thelbësore nga vetë Kur'ani, parime që formojnë bazën e sistemit për shoqëritë tona anëekënd botës muslimane. Kjo është shoqëri e bazuar në parimet kur'anore, ndërsa ky është qëllim i çdonjërit prej nesh, madje edhe kur nga padituria, kohë pas kohe, këto

parime i shtrembërojmë. Kjo është përshtatshmëri ndaj shoqërisë së bazuar në Kur'an, për të cilën duhet të luftojmë të gjithë, nëse dëshirojmë që bota muslimane të jetë ardhmëri. A nuk është versioni indonezian, pakistanez, saudit, egjiptasi ose nigerian i shoqëris, ai që duhet të marrim pa- rasysh si normativë të pamohueshme ose ajo e bazuar fort në Kur'anin Famëlartë? Vetëm këtu mund ta kërkojmë definicionin e drejtë të rolit të femrës në shoqëri. Mësimi i theksuar, i cili në realitet është temë e këtij punimi, dëshmon se kjo është mënyra më e përshtatshme e definicionit.

Me këtë zgjedhje dëshirojmë të theksojmë se Kur'anin Famëlartë duhet pranuar si udhërrëfyes nëpër të gjitha aspektet e jetës. Ky nuk është vetëm burim primar i diturisë mbi besimet, detyrat dhe veprimet religjioze, por është udhërrëfyes për çdo aspekt të civilizimit islam. Në shekujt e kaluar të famës ai ka përcaktuar aktivitetin politik, ekonomik, shoqëror dhe artistik të popujve muslimanë. Nëse dëshirojmë të kemi sukses si pjesëtarë të shoqërisë islame në dekadat dhe shekujt e ardhshëm, duhet ta definojmë mënyrën e të menduarit dhe veprimit tonë në mënyrë të tërësishme.

Besimi nuk është i kufizuar vetëm në pesë shtylla: shehadet, namaz, agjërime, zekat dhe haxh. Besimi, në realitet, është si identik me shprehjen angleze “*religjioni*”, për domethëniet e mëhershme, që përfshijnë çdokënd dhe çdo vrimë të ekzistencës dhe sjelljes së njeriut. Me siguri, qëllimi ynë duhet të jetë orientimi i çdo aktiviteti drejt besimit tonë. Këtë mund ta arrijmë vetëm po

t'i lejojmë Kur'anit Famëlartë të informojë dhe reformojë çdo rrafsh të jetës.

Si hap përpara në këtë drejtim na lejoni që të shqyrtojmë çka duhet të mësojmë nga Kur'ani mbi shoqërinë drejt së cilës duhet të orientohemi dhe si të mendojmë seriozisht mbi efektet e saj në lidhje me pozitën e femrës. Cilat janë karakteristikat themelore të shoqërisë kur'anore, e cila ka simpati të posaçme ndaj femrës?

Do të shqyrtojmë pesë karakteristika, të cilat paraqiten si kryesore, vendimtare dhe të pamohueshme në shoqërinë Kur'anore. Ndonëse janë prezantuar një nga një, çdonjëra prej tyre mbështet të tjerat dhe ndikon në to. Varësia e ndërsjellë e këtyre pesë karakteristikave vështirëson diskutimin mbi çdonjëren prej tyre, pa përmendur të tjerat dhe, natyrisht, ato nuk ekzistojnë dhe nuk mund të ekzistojnë të izoluara njëra nga tjetra.

1. POZITA DHE VLERA E BARABARTË E GJINIVE

Karakteristika e parë e raportit të shoqërisë kur'anore ndaj femrës është barazia e gjinive. Me fjalë të tjera, Kur'ani na mëson që femra dhe mashkulli janë krijesa të Allahut xh. sh., të cilat ndodhen në nivel të njëjtë të vlerës dhe dinjitetit, ndo-nëse rëndësia e barabartë e tyre nuk e konfirmon pohimin mbi barazpeshën e tyre ose identitetin ideal. Barabazia e mashkullit dhe e femrës është konfirmuar me argumente nga Kur'ani, në pjesët të cilat kanë të bëjnë më së paku me katër aspekte të ekzistencës njerëzore dhe të ndikimit të ndërsjellë.

A) PËRMBAJTJET FETARE

I pari nga këto argumente kur'anore që kanë të bëjnë me barazinë e mashkullit dhe femrës janë përfshirë në manifestimet që kanë të bëjnë me përmbajtjet fetare, siç janë burimet e njerëzimit dhe detyrat, shpërblimet dhe dënimet e fesë.

1. Burimet e njerëzimit: Kur'ani është i liruar nga rrëfimet e hasura në Dhjatën e Vjetër, rrëfime të cilat e diskreditojnë femrën. Në të nuk ka aluzion se femra e parë, që Zoti krijoi është qenie e rangut më të ulët në raport me mashkullin e parë. Por mashkulli dhe femra janë krijuar (“nga një njeri u krijuam”) për të komplementuar njëri-tjetrin (Kur'an 4:1, 7: 189). Derisa Teurati dhe Dhjata e vjetër, Evën e konsiderojnë si mashtruese të kopshteve të Edenit, e cila i ndihmon Satanit për të joshur Adamin për mosbindje ndaj Zotit, Kur'ani ndaj çiftit njerëzor sillet krejtësisht me drejtësi.

Të dyt janë njësoj fajtorë për kryerjen e mëkatit; të dyt dënohen njësoj nga Zoti me dëbim nga Parajsa dhe të dyve u falen mëkatet, pasi u penduan.

2. Detyrat fetare, dënimi dhe shpërblimi: Kur'ani nuk është asgjë më pak i qartë në urdhëresat për barazinë e mashkullit dhe femrës në udhëzimet e tij, sa i përket detyrave fetare, shpërblim dhe dënim. Ne mësojmë:

“Muslimanëve dhe muslimaneve, besimtarëve dhe besimtareve, meshkujve të bindur dhe femrave të bindura, meshkujve të singertë dhe femrave të singerta, meshkujve të durueshëm dhe femrave të durueshme, meshkujve të përvuajtur dhe femrave të përvuajtura, meshkujve të cilët ndajnë zekat dhe femrave të cilat ndajnë zekat dhe meshkujve të cilët agjërojnë dhe femrave të cilat agjërojnë, meshkujt të cilët kujdesen për pjesët e turpshme të trupit të tyre dhe femrave të cilat kujdesen për pjesët e turpshme të trupit të tyre, meshkujve të cilët shpesh e përmendin Allahun dhe femrave të cilat shpesh e përmendin Allahun Allahu, vërtetë, për të gjithë ata ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh.” (33:35)

B) DETYRAT ETIKE, DËNIMET DHE SHPËRBLIMET

Kur'ani ia tregon llojit njerëzor barazinë e dëshiruar të dy gjinive me parashtrimin e detyrave etike, dënimeve dhe shpërblimeve të njëjta si për mashkullin ashtu edhe për femrën:

“...kurse ai i cilë bën mirë, goftë mashkull apo femër, por që është besimtar, do të hyjë në xhenet dhe nuk do t'i bëbet e padrejtë as edhe sa një grimë.” (4:124)

“Atij që bën mirë, qoftë mashkull apo femër, kurse është besimtar, ne do t'i dburojmë jetë të mirë dhe, vërtetë, do t'i shpërblejmë me shpërblim më të mirë siç e kanë merituar.” (16:97)

Po të mos i çmonte Allahu Lavdiplotë dhe i Madhëruar të dy gjinitë me pozitë dhe vlerë të barabartë, këto deklarata eksplicite mbi barazinë e tyre, në detyrat etike, dënime dhe shpërblime, nuk do të gjendeshin në Kur'an.

C) ARSIMIMI

Ndonëse dispozita indikative mbi të drejtat e barabarta të femrës dhe mashkullit, në lidhje me tentimin për t'u arsimuar, mund të gjend në literaturën e haditheve, Kur'ani, së paku, shënon nevojën e kërkimit të diturisë për të gjithë muslimanët, pa marrë parasysh gjininë. Për shembull, shumë herë përsëritet dhe i urdhërohet të gjithë nxënësve të mësojnë, të flasin, të vëzhgojnë dhe të marrin shembull nga shenjat e Allahut xh. sh. në natyrë. Në realitet, shpallja e parë që iu paraqit Pejgamberit të Zotit (s.a.v.s.) ka të bëjë me mësimin. Në shoqërinë kur'anore kurrë nuk mund të ketë ndalesë për marrjen e diturisë për asnjërin gjini. Ne na është thënë se është detyrë e çdo muslimani dhe muslimaneje që gjatë tërë jetës të kërkojë dituri, qoftë edhe nëse ky kërkim të shpie deri në Kinë. Pejgamberi (s.a.v.s.) madje ka urdhëruar që të arsimohen edhe vajzat robëresha dhe ka kërkuar nga Shifa b. Abdullahu ta mësojë gruan e vet Hafsan b. Umar. Ligjëratat e Pejgamberit (s. a. v. s.) i kanë ndjekur edhe meshkujt edhe femrat.

Pas vdekjes së Pejgamberit të Zotit, ka pasur shumë femra të arsimuara.

Ç) TË DREJTAT LIGJORE

Dëshmia e katërt në Kur'an mbi barazinë e mashkullit dhe femrës është specifikimi i të drejtave ligjore, të cilat janë të garantuara për çdo individ, prej djepit e deri në varr. Ndryshe nga situata në Perëndim, ku deri në këtë shekull ka qenë e pamundur që femrat e pamartuara të posedojnë pro- në private, të lidhin kontratë me persona të tjerë ose të disponojnë pasuri pa pëlqimin e bashkëshortit, Kur'ani proklamon të drejtën e çdo femre për të shitur ose blerë, për të kontraktuar dhe fituar, për të disponuar dhe administruar me paratë dhe pronën e saj. Si plotësim i këtyre të drejtave, Kur'ani i lejon femrës të drejtën për pjesëmarrje në trashëgiminë familjare (Kur'an, 4:7, 11) dhe tërheq vëmendjen për padrejtësinë e privimit të femrës nga ky trashëgim (Kur'an, 4:19), përcakton që mirazi (mehri) me rastin e lidhjes së martesës duhet t'i përkasë vetëm asaj dhe se bashkëshorti kurrë nuk mund ta marrë atë (Kur'ani, 2:229; 4:19 - 21, 25), vetëm nëse femra këtë e dhuron si shpërblim (Kur'an, 4:44).

Si çdo privilegj, edhe këto të drejta të femrës kërkojnë obligime gjegjëse. Nëse ajo kryen ndonjë krim ligjor (civil), Kur'ani thotë: *“Dënimi për femrën nuk është aspak më i vogël ose më i madh se për mashkullin, për të njëjtin rast”* (Kur'an, 5:41, 24:2). Nëse i është bërë e padrejtë ose dëm, ajo ka të drejtë në kompensim sikurse edhe

mashkulli.

Është evidente se Kur'ani jo vetëm që preferon, por edhe insiston në barazinë e mashkullit dhe femrës, si karakteristikë thelbësore e shoqërisë kur'anore. Bindjet e kritikëve jomuslimanë, se Islami e diskrediton femrën, Kur'ani i përgenjeshtron në mënyrë të qartë. Përgenjeshtrohen gjithashtu edhe tezat e disa muslimanëve, se femra është inferiore në krahasim me mashkullin në aspektin fetar, intelektual dhe etik, siç ka pohuar më herët literatura e krishtere dhe hebraike.

2. MË MIRË SHOQËRI BISEKSUALE SE MONOSEKSUALE

Na lejon qe te analizojme karakteristiken e dyte themelore te shoqerise Kur'anore, e cila ndikon ne pozitën e femrës. Ajo përmbahet në direktivat për përfaqimin e shoqerise biseksuale e jo asaj monoseksuale. Derisa mbështet rolin e barabartë të mashkullit dhe femrës, Kur'ani këtë bara- barësi nuk e konsideron në kuptimin e barazisë ose identitetit të gjinive.

Me siguri se të gjithë ju jeni informuar për lëvizjen bashkëkohore, që preferon veshmbathje monoseksuale, stoli dhe ondu-lacione monoseksuale, veprime dhe argëtime monoseksuale. Në realitet, ky është fenomen i shpeshtë në Amerikë, ku nuk mund të dalloni nëse jeni duke shikuar një mashkull apo një femër. Kjo rrjedh nga qëndrimet aktuale të shoqërive perëndimore, në të cilat është tejet i vogël, nëse ekziston, dallimi mes dy gjinive në aspektin fizik, në funksionet dhe rolet e tyre në shoqëri. Veshmbathja dhe veprimet janë vetëm argumente siperfaqësore të kësaj bindjeje të thellë. E përcjellur me degradimin e kualitetit dhe roleve tradicionalisht të lidhura me gjininë femrore, kjo ide aktuale ka krijuar shoqërinë monoseksuale, në të cilën është ruajtur dhe është përcjellë vetëm roli i mashkullit.

Shumica mendon se kjo sjell nivel më të lartë. Ideja që mashkulli dhe femra nuk janë të barabartë, në realitet e ka detyruar femrën të imitojë mashkullin, madje edhe ta urrejë

feminitetin. Prej kësaj formohet një tip i ri i shovenizmit mashkullor. Trysnitë e tmerrshme shoqërore kanë ndikuar që femra të heqë dorë nga roli dhe detyrat e saj të cilat i ka kryer më parë dhe është detyruar të jetojë pa identitet personal dhe individuallitet.

Përkundër kësaj, shoqëria e bazuar në Kur'an është shoqëri biseksuale, në të cilën të dy gjinitë i janë përcaktuar përgjegjësisë së posaçme. Kjo siguron funksionimin e shëndoshë të shoqërisë dhe mirëqenien e të gjithë pjesëtarëve të saj. Kjo ndarje e punës mashkullit i ngarkon detyra – përgjegjësi më tepër të natyrës ekonomike (Kur'an, 2:233, 240 - 241; 4:34), derisa nga femra kërkohet të luajë rolin e vet në rritjen dhe edukimin e fëmijëve (Kur'an, 2:233; 7:189). Duke dalluar rëndësinë e kësaj bartjeje të roleve dhe detyrave të gjinive, Kur'ani kërkesat më të mëdha në planin ekonomik, ia lehtëson pjesës mashkullore të popullsisë, duke i dhënë hise më të madhe se femrës në trashëgimi. Njëkohësisht, Kur'ani femrës i jep të drejtë në mbajtje, si zëvendësim për kontributin e saj në mirëqenien fizike dhe emocionale dhe për kujdesin, të cilin ajo e shpenzon për rritjen e fëmijëve. Ideologjia monoseksuale pro-dhon raport garues mes gjinive, të cilin e hasim në Amerikë dhe i cili është i kobshëm për të gjithë anëtarët e shoqërisë: të rinj, pleq, fëmijë, prindër, individë, çifte bashkëshortore, meshkuj dhe femra. Përkundër kësaj, shoqëria biseksuale paraqet përgjegjen më të natyrshme në çështjen e raporteve midis gjinive, bazë e cila nxit bashkëpunimin dhe jo garën midis gjinive. Kjo është baza që gjatë historisë ka

qenë e përshta- tshme për shumë shoqëri. Ideja e identifikimit ose e barazisë së gjinive ka gjetur shprehje vetëm në kohën e vonshme, në rend të parë në shoqëritë perëndimore. Madje edhe argumentet medicinale mbi dallimet mentale dhe emocionale midis gjinive në hulumtimet perëndimore janë lënë pas shpine, ngase paraqesin kanosje për trendin e tyre dominues të mendimit. Sa gjatë do të ekzistojë kjo lëvizje katastrofale për shoqërinë, para se të braktiset si shkatërruese, nuk dihet. Megjithatë ne, si muslimanë, me siguri duhet të jemi të vetëdijshëm për pasojat e saj të dëmshme dhe të rrezikshme, ndërsa në shoqëritë tona ta edukojmë rininë që ajo të kuptojë shkatërrimin që sjell kjo ide.

Protagonistët e shoqërisë monoseksuale e akuzojnë organizimin biseksual të njerëzimit si rrezik për mirëqenien e femrës. Nëse shoqëri biseksuale do të thotë se njëra gjini është superiore në krahasim me tjetrën, një gjë e tillë do të mund të pranohej. Mirëpo, në shoqërinë e njëmendtë kur'anore, drejt të cilës janë orientuar aspiratat tona, kjo gjë nuk është e mundur. Siç kemi parë më lart, Kur'ani mbështet fuqimisht barazinë e pozitës së femrës dhe të mashkullit, duke i shënuar njëkohësisht ndryshimet funksionale dhe karakteristikat me rëndësi të përgjithshme.

Derisa verteton barazinë fetare, morale, intelektuale dhe ligjore të mashkullit dhe të femrës, Kur'ani kurrësesi nuk konsideron se këto dy gjini janë identike ose në baraspeshë. Ai këtë qëndrim e arsyeton me përcaktimin e detyrave të ndryshme, dhe me paisjen, respektivisht trashëgiminë dhe mbajtjen rreth të cilave i balancon

këto detyra.

3. VARSHMËRIA RECIPROKE E ANËTARËVE TË SHOQËRISË

Karakteristika e tretë e shoqërisë kur'anore, në lidhje me pozitën e femrës, insiston në varshmërinë reciproke të pjesëtarëve të shoqërisë. Përkundër trendit bashkëkohor të potencimit të të drejtave të individit karshi shoqërisë, Kur'ani shumë herë thekson varshmërinë reciproke të mashkullit dhe femrës, respektivisht të të gjithë anëtarëve të shoqërisë. Bashkëshorti dhe bashkëshortja, për shembull, janë përshkruar si veshje e njëri-tjetrit (Kur'an, 2:187) dhe si bashkëshortë të cilët jetojnë së bashku dhe çojnë jetë të rehatshme (Kur'an, 33:2; 7:189). Mashkulli dhe femra janë të orientuar të plotësojnë njëri-tjetrin, e jo të bëjnë garë midis tyre. Ata janë mbrojtës të njëri-tjetrit (Kur'an, 9:71). Çdonjëri është i ftuar të kryejë detyra të caktuara për mirëqenien e të dyve, por edhe të të tjerëve. Duke e urdhëruar dhe siguruar këtë varshmëri reciproke, e cila është tejet e nevojshme për mirëqenien fizike dhe psikologjike të mashkullit dhe të femrës, Allahu xh.sh. në Kur'a-nin Famëlartë i ka përcaktuar detyrat dhe obligimet reciproke dhe të dyanshme për pjesëtarët e familjes - bashkëshortin dhe bashkëshorten, baballarët dhe nënat, fëmijët dhe të moshuarit dhe të afërmit e të gjitha niveleve (Kur'an, 17:23 - 26; 4:1,7 - 12; 8:41; 16:90 etj.). Vëmendja dhe kujdesi për anëtarët e tjerë të shoqërisë, gjithashtu është detyrë e muslimanit.

“Nuk paraqet devocion të ktbeni fytyrat tuaja drejt Lindjes dhe Perëndimit; të devotsbëm janë ata të cilët besojnë në Allahun, edhe në botën tjetër, edhe në melekë, edhe në libra, edhe në Pejgamberë dhe të cilët një pjesë të pasurisë së tyre, ndonëse u është e dashur, ia falin të afërmëve, edhe jetimëve edhe të varfërve, edhe shtegtarëve të rastit, edhe lypësve, edhe si kompensim për të zënë rob.” (2:177)

Në këtë mënyrë Kur'ani ua forcon muslimanëve ndjenjën për përgjegjësi dhe vend në shoqëri. Kjo nuk është marrë parasysht ose nuk është kuptuar si represion ndaj individit. Për-kundrazi, muslimani në mënyrë konstante është cytur për varshmërinë reciproke duke pasur parasysht përparësitë që dalin nga ajo. Përparësitë ekonomike, shoqërore dhe psikologjike të këtyre rapor- teve dhe interesimeve të ngushta reciproke, brenda një grupi shoqëror, sigurojnë më tepër se kompensim për individin me qëllim të fisnikërimit të aspiratave të tij apo saj individuale. Anoni- miteti dhe mungesa e varshmërisë së ndërsje-llë shoqërore te pjesëtarët e shoqërive bashkëkohore perëndi-more ka shkaktuar shumë probleme serioze. Vetmia, kujdesi joadekuat për të moshuarit, humnerat midis gjeneratave, përqi-ndja e lartë e vetëvrasjeve dhe kriminaliteti fëmijëror dëshmo- jnë thelbin e thyerjes së vazhdueshme të varshmërisë reciproke dhe mohimit të nevojës së njeriut për kujdes të ndërsjellë.

4. FAMILJA E ZGJERUAR

E lidhur ngushtë me varshmërinë reciproke është karakteristika

e katërt themelore e shoqërisë kur'anore, e cila shërben për fisnikërimin e marrëdhënieve midis mashkullit dhe femrës. Kjo është themelimi i familjes së zgjeruar. Si shtojcë e pjesëtarëve të bërthamës, që sajón familjen - nëna, babai dhe fëmijët e tyre - familja islame ose a' ilah familja përfshin gjithashtu gjyshërit, gjyshet, dajallarët, xhaxhallarët, tezet dhe pasardhësit e tyre. Familjet muslimane zakonisht jetojnë në “banesa të zgjeruara”; që do të thotë se anëtarët e tyre jetojnë bashkari-sht nga tri ose më shumë gjenerata të afërmish në një objekt banimi ose kompleks banesash. Gjithashtu, aty ku ky version i banimit të familjes së zgjeruar nuk është i mundur ose përfundojnë, lidhjet familjare arrijnë larg bërthamës së familj-es, gjë që mund të shihet në lidhjet e fuqishme psikologjike, shoqërore, ekonomike, madje edhe politike.

Unanimiteti i familjes së zgjeruar është rregulluar edhe vërtetuar me Kur'anin Famëlartë, në të cilin gjejmë udhëzime mbi të drejtat e lidhjes së gjakut (Kur'an, 17: 23 - 26; 4:7 - 9; 8:41; 24:22 etj.). Hisja nën trashëgim, jo vetëm për pjesëtarët e bërthamës së familjes, por edhe për ata nga familja e zgjeruar, është e rregulluar posaçërisht (Kur'an, 2:180; 4:33, 176). Dënimi i tmerrshëm kanoset dhe u ofrohet atyre të cilët nuk i përfillin këto masa të përkrahjes brenda familjes (Kur'an, 4:7-12). Prandaj, familja e zgjeruar e kulturës islame nuk është vetëm produkt i konditave shoqërore, ajo është ligj i rrënjosur, strehim në Fjalën e Zotit, e konfirmuar me këshilla dhe rregulla kur'anore.

Janë shumë të mëdha përparësitë edhe për mashkullin edhe për

femrën kur jetojnë në pajtim me karakteristikat e tjera themelore të shoqërisë Kur'anore:

1. Sigurohet nga egoizmi dhe ekscentrizmi nga çdonjëra anë, meqë individi nuk ballafaqohet me bashkëshortin, por me tërë familjen e paraardhësve, pasardhësve dhe fëmijëve, nëse ai ose ajo largohen “nga kursi”.

2. Lejon karrierën e femrës, e cila punon pa cënuar funksionin e bashkëshortes dhe nënës. Suksesi i femrës në familjen e zgjeruar islame nuk vuan nga barra fizike dhe emocionale e punës jashtë orarit, as nga ndjenja e fajit për shkak të lënies pas dore të obligimeve familjare si nënë dhe bashkëshorte. Në realitet, pa këtë mënyrë të rendit familjar është e pamundur të paramendohet ndonjë zgjidhje e dobishme e problemit me të cilin është ballafaquar shoqëria perëndimore. Sa më shumë që femrat hyjnë në përbërje të fuqisë punëtore, bërthama e familjes bëhet gjithnjë më e paaftë t'i përballojë nevojat e anëtarëve të saj. Vështirësitë në familjet me një prind, natyrisht, janë shumfish më të mëdha. Vështirësitë, që sistemet e tilla familjare parashetrojnë para femrës së punësuar janë shka-trimtare për individin, për martesën dhe lidhjet familjare. Shpërbërjet e familjeve, ndarjet psikologjike dhe shoqërore dhe shkalla e lartë e shkurorëzimeve në Amerikë dhe në vendet e tjera perëndimore sjellin preokupimet e shtuara të mjekëve, avokatëve, psikiatërve dhe sociologëve, si dhe, natyrisht, të viktimave fatkeq të këtyre fenomenëve.

3. Familja e zgjeruar siguron socializmin adekuat të fëmijëve.

Këshilla e babait dhe e nënës në bërthamën familjare, ose në familjen me një prind, mund të tregohet e papranueshme për fëmijët tekanjozë, mirëpo presioni i të gjithë anëtarëve të familjes së zgjeruar është kundërlëvizje e efekt- shme për mosdëgjim dhe mosbindje.

4. Familja e zgjeruar paraqet siguri nga varietetet psikologjike dhe sociale në shoqëri, si për të rriturit ashtu edhe për fëmijët, pasi varshmëria më e vogël në raportin e njërit ndaj tjetrit rezulton me nevoja më të vogla emocionale të çdo anëtar i familjes.

Mosmarrëveshjet dhe divergjencat midis të rriturve, fëmijëve dhe personave të gjeneratave të ndryshme nuk arrijnë përmasa dëmtuese, siç mund të ndodhë në familjen e cila përbëhet vetëm nga bërthama e saj. Gjithmonë ka anëtarë alternativë të familjes që ndodhen afër, janë të gatshëm ta lehtësojnë dhimbjen dhe të ofrojnë këshillë gjegjëse dhe shoqëri. Madje edhe lidhja bashkëshortore nuk përjeton vuajtje.

5. Familja e zgjeruar ose familja a'ilah është siguri kundër zhvillimit të sketërrave midis gjeneratave. Ky problem shoqëror paraqitet kur një grup i moshuar bëhet aq i izoluar nga gjeneratat e tjera, saqë paraqet vështirësi për realizimin e veprimit të suksesshëm dhe me rëndësi reciproke për njerëz të moshave të ndryshme. Në familjen e zgjeruar tri ose më tepër gjenerata jetojnë së bashku dhe bashkëpunojnë në mënyrë konstante njëri me tjetrin. Kjo situatë mundëson mësimin e dobishëm dhe socializimin e përvojave për fëmijë dhe ndjenjën e domosdoshme

të sigurisë dhe dobisë për gjeneratat më të vjetra.

6. Familja e zgjeruar eliminon problemet e vetmisë, të cilat rëndojnë banorët e izoluar dhe anonim të mjediseve urbane të shumë shoqërive bashkëkohore. Femra e pamartuar dhe e ndarë ose e ve, në familjen e zgjeruar islame kurrë nuk do të vuajë nga problemet me të cilat ballafaqohet femra në shoqërinë bashkëkohore amerikane. Në shoqërinë kur'anore nuk ka nevojë për kompjuterë të cilët kontraktajnë takime, as për klube dhe bare për të vetmuarit, ose për izolimin e personave të moshuar në fshatrat e qytetëruara ose shtëpitë e pleqve. Nevojat shoqërore dhe psikologjike qoftë të mashkullit ose të femrës në familjen e zgjeruar janë të siguruar.

Ndërkohë që lidhjet martesore në shoqëritë perëndimore bëhen gjithnjë e më të dobëta, femrat janë viktimat kryesore të ndryshimeve. Ato janë më pak të afta se meshkujt që të rregullojnë martesë ose lidhje të tjera, kurse në planin psikologjik janë më shumë të goditura nga këto humbje.

7. Familja e zgjeruar siguron përkujdesje më të dobishme dhe më humane për të moshuarit. Në familjen e përbërë vetëm prej bërthamës kujdesi për prindërit e moshuar, ose prindërit e njerit prej bashkëshortëve, mund të bjerë vetëm mbi një indi-vid, zakonisht mbi nënën e familjes. Ajo duhet t'u ofrojë përkujdesje të posaçme fizike si dhe të sigurojë mirëqenien emoci-onale të të moshuarve.

Kjo është barrë shumë rëndë mbi shpinën e femrës, e cila

përveç kësaj ka obligimi të përmbushë kërkesat e fëmijëve dhe të bashkëshortit. Nëse është nënë e punësuar, kjo barrë mund të jetë e padurueshme, e në këtë rast të moshuarit vendosen nëpër shtëpitë për pleq, ku presin vdekjen. Me ndarjen e përgjegjësive dhe detyrave, që e siguron familja e zgjeruar, barra bëhet dukshëm më e lehtë.

5. ORGANIZIMI PATRIARKAL I FAMILJES

Karakteristika e pestë themelore e shoqërisë kur'anore është patriarkalizmi. Në kundërshtim me qëllimet e *“Lëvizjeve për femrën e lirë”*, Kur'ani angazhohet për një shoqëri e cila rolin e udhëheqjes dhe vendosjes në familje ia ndan mashkullit.

Çdo shoqëri është e ndarë në organizata më të vogla të administrimit njerëzor, partive politike, organizatave fetare, ndërmarrjeve komerciale, familjeve të zgjeruara etj. Është e nevojshme që çdonjëra nga këto organizata të jetë stabile, kohezive dhe e shkathët, nëse dëshiron të jetë e dobishme për anëtarët e vet. Me qëllim të arritjes së këtyre karakteristikave, organizata duhet të ndajë përgjegjësinë kryesore për individin ose grupin e caktuar brenda radhëve të veta.

Prandaj, qytetarët mund të votojnë, Kuvendi mund të aprovojë, policia mund të zbatojë ligje, mirëpo kreu udhëheqës i shtetit është ai që e mban barrën e sjelljes së vendimeve vendimtare për kombin, si dhe përgjegjësinë ose meritat për këto vendime.

Edhe familjes gjithashtu i nevojitet dikush që do ta mbartë barrën e përgjegjësisë kryesore për çdo gjë. Kur'ani këtë rol ia ka dhënë mashkullit më të moshuar të familjes. Kjo është dispozitë patriarkale e pushtetit dhe e përgjegjësisë, e karak-terizuar në këtë mënyrë: - *“vetëm bashkëshortët kanë përpa-rësi para tyre për një shkallë. “ (2:228), si dhe “meshkujt përkujdesen për femrat...” (4:34). Në kundërshtim me komentimet e shtembëruara të armiqtve të Kur'anit, këto ajete nuk shprehin nën- shtrimin e femrës ndaj*

mashkullit nga diktatura e bazuar në gjini. Interpretimi i tillë paraqet paturpësi vulgare ndaj thirrjeve kur'anore për barazi të gjinive dhe ndaj dispozi-tave të tij për shprehjen e respektit dhe kujdesit ndaj femrës. Përkundër kësaj, ajetet e cituara shprehin mënyrën e shmangies nga përçarjet intelektuale, në favor të pjesëtarëve të familjes. Ata preferojnë një shoqëri patriarkale.

Në vazhdim vëmendja duhet përqëndruar në përdorimin e fjalës “kavvamum” në deklaratën *“Meshkujt përkujdesen për femrat”* (4:34). Nuk ka dyshim se shprehja (folja) kavvama nga e cila është nxjerrë emri “kavvamum”, nuk implikon sovranitet despotik. Në vend të kësaj, kjo shprehje aludon në atë që qëndron përpara diçkaje (prej kame - qëndrojë) për shkak të dikujt tjetër në formë të mbrojtjes dhe admirimit. Nëse roli autokratik dhe tiranizues i gjysmës mashkullore të shoqërisë është nënkuptuar, ekzistojnë shumë shprehje shumë më të përshtatshme, për shembull, “musejtirum” dhe “muhejminun”. Shembuj të tjerë të përdorimit kur'anor të shprehjes “kava- mun” konfirmojnë mbështetës e jo autokratik dhe tiranizues të kësaj shprehje (shih. 4:127 - 135; 5:9). Prandaj, përshkrimi i domethënive të ndryshme, dhe i fragmentit të ajetit në të cilin ndo- dhet fraza e cituar në aspektin ideologjik është kontradiktor dhe gjuhësisht i paqëndrueshëm.

Përse Kur'ani specifikon udhëheqjen e mashkullit në familjen e zgjeruar patriarkale dhe jo organizimin matriarkal? Kur'ani, në lidhje me këtë çështje, përgjigjet në këtë mënyrë: *“Meshkujt përkujdesën për femrat pasi Allahu u ka dhënë përparësi njërit ndaj tjetrit dhe pasi ata shpenzojnë pronën e tyre.”* (4:34).

Kontributi fizik dhe ekonomik dhe përgjegjësitë janë shkaqe kur'anore për themelimin e shoqërisë patriarkale dhe matriarkale.

Disa perëndimorë, të ballafaquar me problemet e shoqërisë bashkëkohore, fillojnë të parashtrojnë pyetje si: Ku mund të drejtohem për ndihmë? Ç'mund të bëjmë kur kemi parasysh dezintegrimin e sotëm shoqëror? Kjo është kohë e dëshpërimit dhe e eksperimentimit, në të cilën shoqëria perëndimore bie moralisht nën eksplozionet e rritjes permanente të dezorientimit njerëzor dhe shkatërrimit shoqëror.

Ç'mund të bëjmë ne si muslimanë? Para së gjithash, duhet të krijojmë një shoqëri të vërtetë kur'anore në botën muslimane. Pa këtë nuk mund të themelojmë një sistem objektiv dhe të aftë për jetën dhe veprimin reciprok të mashkullit dhe femrës në shoqëri. Nuk mund të shpresojmë se gjeneratat e ardhshme do të nxisin lojalitet dhe respekt ndaj shoqërive tona dhe institucioneve të tyre përcjellëse, nëse vetëm shoqëritë pseudo-islame janë të afta për prodhues dhe mbajtje. Masat dhe institucione pseudo-islame janë njëmend antiislame, pasi postulojnë modele të cilat nuk mund të merren me shqyrtim dhe frenojnë etiketën "Islame". Në kokat e shumë muslimanëve, por edhe të jomuslimanëve, kjo gjë prodhon mbartjen e gabuar të obligimeve, të institucioneve të prishura të vetë Islamit.

Duhet të jemi të arsimuar dhe t'i arsimojmë muslimanët e tjerë, e posaçërisht rininë e cila është mbartëse e së nesërme, duke marrur parasysh rëndësinë dhe qëndrueshmërinë e traditave tona

dhe të tyre kur'anore në lidhje me femrën, familjen dhe shoqërinë. Përkundër mospërkrahjes së modeleve alternative bashkëkohore të shoqërive perëndimore, disa muslimanë e mbajnë barazinë e damkosur perëndimore të gjinive, idetë e tyre monoseksuale dhe mënyrat e sjelljes, me theksin e tepërt të individualitetit dhe lirisë personale nga përgjegjësia, si dhe sistemin e familjes që shërbehet vetëm prej bërthamës së saj. Duhet të jemi vigjilentë para rreziqeve të cilat arrijnë nga këto ide dhe praktika shoqërore, ngase, nëse nuk u kundërvihemi me kohë, jemi të gjykuar me ardhmëri fatale, ngase rezultati përfundimtar i eksperimenteve të tilla shoqërore paraqet dështim total.

Mirëpo, edhe kjo nuk është përgjigje adekuatë për ne si muslimanë. Si mëkëmbës të Allahut xh. sh. në tokë (Kur'an, 2:30), ne duhet të kujdesemi për tërë botën dhe të gjithat krijesat njerëzore. Në dritën e urdhrit për transmetimin e vullnetit të Allahut xh. sh. në çdo pjesë të Tokës, ne nuk duhet të harrojmë që mirësinë, të cilën e njohim, duhet t'ia preferojmë edhe të tjerëve. Është koha për Islamit dhe muslimanët që të paraqesin zgjidhjet e tyre të problemeve të shoqërisë bashkëkohore, jo vetëm në opinionin musliman, por edhe në atë jomusliman. Kjo mundet dhe duhet të kryhet përmes shembujve jetësorë të shoqërisë së vërtetë kur'anore, në të cilën problemet e mashkullit dhe femrës zgjidhen. Kjo duhet të realizohet nëpërmjet shkrimeve dhe shqyrtimeve informatike të shkencëtarëve tanë, të cilët duhet të jenë njësoj të dobishëm për muslimanë dhe jomuslimanë. Nuk ka rrugë më të mirë se t'i shërbesh vullnetit të

Allahut xh. sh. dhe kompaktësisë së llojit njerëzor. Nuk ekziston bar më i mirë se shtrirja e dorës për ndihmë për viktimat e shoqërisë bashkëkohore.

SHËNIME:

1. “Hipokritëve dhe hipokriteve dhe pabesimtarëve Allahu u kanoset me zjarrin e Xhehenemit, ata do të qëndrojnë përgjithmonë në të, ajo do t'u mjaftojë! Allahu i ka mallkuar dhe ata i pret vuajtja e pafund.” (9:69)
2. Shih gjithashtu (9:67 - 72)
3. Ky është hadith i Pejgamberit të Zotit, Muhammedit (s.a.v.s.). Të shihet gjithashtu - Muhammed 'Izzat Darwazah, *Al-Mar'af fi al-Qur'an wal Sunnah* (Beirut: al-Maktabah al- 'Asriyyah, 1980) f. 44, 47, 51.
4. Muhammed Fu'ad' Abd al-Baqi, *al-Lu'lu wal Marjan fi ma ittafaqa fih al-Shaykani* (Beirut: Dar al-Kitab al-Jadid, 1970), I, f. 30 - 31.
5. Hajji Faysal ibn Hajji Uthman, “Women and Nation-Bulding: Systematicana Conteporary Malay Muslim Society (Ph. D. dissetation to be presented to Temple Uniwersity), f. 85.
6. Muhammed Khayrat, *Markaz al-mar'ah fi al- 'Islam* (Cairo: Dar al-Ma'arif, 1975), f. 108.
7. Monrad G. Paulsen. “Women, Legal Rights of”, *Encyclopedia Americana* (Dunbary, Con.: Americana CCorp., 1980), 29, f. 108 - 109.
8. “...Meshkujve u takon shpërblimi për atë që ata bëjnë, ndërsa

femrave për atë që ato bëjnë...” (4:32)

9. Shih: Mustafa al-Siba'i, al-Mar'ah bayn al-fiqh wal qanun (Aleppo: Al-Maktabah al-'Arabiyyah, 1976), f. 38.;

Muhammad 'Izzat Darwazah, Al-Dastur al-Qur'ani fi Shu'un al-Hayat (Cairo 'Isa al-Babi al- Halabi), f. 78.

10. “O besimtarë, ju ndalohet që femrat t'i trashëgoni si sende përkundër vullnetit të tyre dhe t'iu shkaktoni vështirësi, me qëllim që diçka nga ajo që u keni dhuruar të përvetësoni, pos nëse gabon dukshëm. Jetoni në lumturi me to! Ndërsa, nëse ndaj tyre ndjeni neveri, është e mundur që mu në atë për të cilën ndieni neveri, Allahu ka dhënë mirësi të madhe.” (4:19)

11. Në përshkrimin e lëvizjes për lirinë e femrës në Amerikë, Karolina Bird shkruan: “Ajo do ta mënjantonte pasqyrën e dallimeve të vërteta midis natyrës së mashkullit dhe të femrës me citate të përgjithësuara me qëllim që të legali-zojë këto konvenca të tyre (martesa, familja, marrëdhëniet e mashkullit dhe femrës etj.)” (“Women's Liberation”, Encyclo-pedia Americana, 29, f. 111a.).

12. Në vitin 1979 në SHBA, krahas 2.331.000 martesave, ka pasur 1.181.000 shkurorëzime, në bazë të almanakut të vitit 1983. Çdo vit shkalla e përqindjes së shkurorëzimeve rritet dukshëm.

13. Kavvamun - kujdestari, ai i cili përkujdeset për dikë.

14. Musejtirun – drejtues.

15. Muhejminun - ai nën mbikëqyrjen e të cilit ndodhet çdo gjë.

16. Organizata matriarkale - femra si kryetare e familjes ose e fisit.

17. Shënim i redaktorit: Autorja e nderuar e këtij artikulli ka paraqitur argumente në favor të familjes së zgjeruar, në kuptimin e familjes e cila përfshin: “gjyshërit, gjyshet, dajalla-rët, xhaxha-

llarët, tezet dhe pasardhësit e tyre, të cilët jetojnë së bashku në një ndërtesë ose kompleks ndërtesash. Ndonëse është e vërtetë se Islami preferon marrëdhënie të afërta dhe të ngrohta mi- dis atyre që janë në lidhje gjaku (33:50; 24:61) dhe me fe (49:10; 59:10), ekzistojnë pak argumente në Kur'an ose traditë për çfarëdo simpatie ndaj jetës së tyre të përbashkët në një ose “kompleks ndërtesash”, kjo simpati nuk është dëshmuar nga argumentet historike, duke pasur për bazë bashkësinë e parë muslimane nga koha e Pejgamberit të Zotit (s.a.v.s.). Megjithatë, argumentet e saj në favor të familjes “së zgjeruar” nuk janë në kundërshtim me faktet islame.

STATUSI I FEMRËS NË ISLAM

FEMRA - GJYSMA E TRUPIT TË SHOQËRISË ZGJIDHJA E PROBLEMEVE SOCIALE

Vështirësia më e madhe me të cilën ballafaqohemi gjatë zgjidhjes së problemeve sociale është ajo nën ndikimin e faktorëve, si janë doket dhe traditat, shprehitë, ndjenjat, imitimet e verbëra etj. Prandaj, është plotësisht e mundur që të largohemi nga e vërteta dhe të gabojmë në dallimin e asaj që është e drejtë dhe asaj që është e gabuar.

Prej problemeve që kanë të bëjnë me logjikën dhe shkencën, në çfarëdo mënyre, kjo vështirësi nuk paraqitet. Në shkencë së pari tubohen premiset kryesore dhe përmes deduksionit logjik mund të arrihet një konkluzion i drejtë. Me fjalë të tjera, në rast të dallimit dhe të mosmarrëve-shjes, ato prezantohen në edicionet shkencore ose filozofike në lidhje me mungesën e domethënies dhe pajisjeve adek-uate ose me mungesën e konkluzioneve logjike. Problemet sociale, në anën tjetër, janë gjë e përparësisë dhe e humbj-es, idealeve dhe dëshirave të klasave të llojllojshme në shoqëri. Edhe këtu shumica e dallimeve dhe e vërejtjeve del në pah si rezultat i të drejtave dhe i detyrave duke rënë shumë shpesh në konflikt, shkaku i të cilit është disa individë i përkasin teorive të njohura, fakti se u kundërve-hen pikëpamjeve të të tjerëve dhe se motivet e tyre i bazojnë në kundërshtim me ata që janë adhurues të së vërtetës, d. m. th. janë në kundërshtim me të drejtën sociale dhe funksionimin e sistemuar të shoqërisë.

Kjo ndodh pasi shpesh oratoria, poetika dhe propaganda mashtruese e zëvendësojnë mendimin logjik. Rezultati është, në vend të kërkimit të ndihmës nga ekspertët, nga shkencëtarët e paanshëm dhe nga njerëzit e ditur dhe në vend të fillimit të këshillimeve, ku do të merrnin pjesë stu-dieusit eminentë, diskutimeve pa paragjykime dhe hulumtimeve, qasje ndaj analizave të zhurshme dhe grindjeve, kurse përpjekjet janë orientuar drejt mashtrimit dhe nxitjes së mendimit të ndryshuar.

Duke shkuar kësaj rruge, është evidente se gjërat po keqësohen. Njerëzit e shquar, gjenitë, të cilat janë krenaria e llojit njerëzor, mund të pengohen fare lehtë. Mund të ndalet nga udhëheqësit, liria e të folurit dhe e të shkruarit. Gojë-këqinjt dhe mercenarët, helmuesit e fjalës së shkruar, jo vetëm që mund të dominojnë, por do të shkonin edhe më larg të nxitur nga synimet e tyre egoiste. Në këto synime dominon shtrembërimi i rendit dhe mund të merret me mend lehtë cili do të ishte fati i shoqërisë. Pra, kushti krye-sor për sjelljen e konkluzioneve të bazuara pozitivisht në edicionet e lartshënuara do të ishte t'i analizojmë nga një këndvështrim objektiv, i cili kërkon vetëm të vërtetën e liruar nga të gjitha emocionet, perdet e zymta të pasioneve dhe nga të gjitha ndikimet që mund të bëjnë doket dhe shprehitë. Vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet e vërteta dhe mund të nxirren konkluzione të drejta. Përveç kësaj, gjatë hulumtimit objektiv të këtyre edicioneve dhe gjatë kuptimit të së vërtetës, përmes fakteve, duhet të kihet parasysh masat e ndryshme që orientojnë jetën e njeriut, veprimtarinë e tij sociale dhe ligjet e kauzalitetit.

Prandaj, para konkluzionit kategorik, duhet të peshohen me vëmendje pikat e dobëta dhe të forta të pikëpamjeve materiale, shpirtërore, individuale e sociale. Gjithashtu, te vëzhgimi i faktorëve që mohojnë të tjerët, atyre që janë më të rëndësishëm u duhet dhënë përparësi.

Për fat të keq, në analizën e këtyre edicioneve zakoni-sht dominon simpatia e fuqishme subjektive. Si pasojë e kësaj, drejtimitet e dëshmuara shkencëtarisht dhe ata paqë-dashës ia lëshojnë vendin drejtimeve kolonialiste dhe tiranizuese.

Imitimi i verbër është njëri nga faktorët që ka ushtruar ndikim negativ në zgjidhjen e problemeve sociale. Gjithsesi, numri i madh i të drejtave që kanë qenë të shtypura dësh-mon mbi imitimin e verbër dhe të paafte të paraardhësve ndaj kulturave të huaja të cilat, duke penguar shumë shoqë-ri, i kanë sjellur gjer aty sa të arrijnë në gjendjen e mjerue-shme të ngulfatjes së pafuqishme.

Prandaj, siç u tha më lart për studimin intelektual dhe logjik të këtyre edicioneve dhe mendimeve që synojnë të vërtetën, duhet të largohemi nga ndikimet negative të cilat mund të prodhojnë efektin e përshkruar më sipër. Veç kësaj, duhet pasur gjykim objektiv larg nga të gjithë subjektivi- zmat qoftë nga lindja ose perëndimi, si dhe pasqyrim i pastër larg nga të gjitha pasionet dhe motivet egoiste.

LOGJIKA E NATYRËS NJERËZORE

Kohëve të fundit në shoqërinë tonë diskutohet shumë mbi çështjen e të drejtave të femrës. Kjo ka ardhur në shprehje në ngjarjet për të cilat, më pak ose më shumë, jemi të vetëdijshëm të gjithë. Mirëpo, nuk do të diskutojmë për një studim të themeltë të të drejtave të femrës (kur ato përbëj- në gjysmën e popullsisë botërore), duhet të shqyrtojmë pozitën e saj në natyrë dhe shoqëri, si dhe të zbulojmë cilat janë lehtësimet dhe vlerat në natyrë ose në konditat fetare të dhuruara me pushtetin dhe urtinë e Zotit.

Kur'ani Famëlartë, libri i fundit i përkryer i Zotit dhe udhërrëfyesi i përhershëm për njeriun, duke na udhëzuar drejtë prosperitetit dhe shpëtimit në këtë dhe botën tjetër, na tregon se ligjet sociale duhet të formohen në harmoni me natyrën e njeriut:

“Drejto fyturën tënde drejt fesë, si besimtar i vërtetë; fesë e cila është vepër e Allahut, në të cilën Ai i krijoi njerëzit, nuk dubet ndryshuar feja e Allahut, ngase ajo është fe e vërtetë, mirëpo shumë njerëz nuk e dinë këtë.”
(30:30)

Logjika e Kur'anit është unikale dhe asnjë shkencëtar ose studjues nuk mund ta arrijë këtë logjikë pa marrë para-sysh sa e studion.

Ne i ftojmë të gjithë ata që pohojnë se kanë gjetur logjikë më të mirë që ta dëshmojnë këtë. Me të vërtetë, a mund të ekzistojë ndonjë logjikë aq e mirë dhe e saktë? Në këtë pyetje mund të përgjigjemi qartë atëherë kur të sqarojmë përse natyra e njeriut

duhet të jetë bazë e të gjitha ligjeve dhe rregullave.

Është fakt i pranuar bashkërisht, si nga filozofët e vjetër ashtu edhe nga ata bashkëkohorë, se çdo qenie e gjallë është e pajisur me sistemin me ndihmën e të cilit i është siguruar ekzistenca. Eksperimentimi dhe rezultatet pasuese pa dyshim e kanë dëshmuar këtë. Është evidente se ekziston një nevojë e vogël për argumente ose për gjykim modern teknik, kurse një studim i shkurtër i jetës së qenieve të gjalla, bimëve ose shtazëve do të dëshmonte këtë fakt.

Për shembull, është e përbashkët njohuria se qeniet e gjalla kanë nevojë për lloje të ndryshme të ushqimit në harmoni me nevojat e tyre. Përveç kësaj, natyra çdo qenie të gjallë e ka pajisur me një sistem të caktuar për tretje, i cili flet vetvetiu për qëllimin për të cilin është krijuar dhe ushqimi i cili i përshtatet.

Studimi i organeve për tretje të shtazët barëngrënëse dhe ato mishngrënëse dhe dallimet evidente mes dhëmbëve, stomakut, zorrëve të tyre dhe gjërave të tjera mund të jetë argument i vërtetë dhe fakt vendimtar, i cili e vërteton qëndrimin tonë. Prandaj, shkencëtari duke dhënë udhëzime se si duhen ushqyer shtazët duhet të marrë parasysh dallimet e sistemeve për tretje të këtyre shtazëve, mbi të cilët duhet t'i bazojë udhëzimet e tij. Natyrisht, meqenëse shtazët veprojnë sipas instiktit dhe jo sipas logjikës, atyre këto udhëzime për t'u ushqyer nuk u nevojiten.

Përveç kësaj, për të arritur dobi optimale nga potenciali i

qenieve të gjalla duhen studiuar mekanizmat e tyre natyrore, me qëllim të njohjes më të mirë të aftësive, fuqisë, kufizimit të tyre, si dhe mënyrës së funksionimit të tyre. Prandaj, mënyra më e mirë që të caktohen detyrat ose të drejtat e qenieve të gjalla është të studiohen në mënyrë të drejtë mundësitë dhe kualiteti i tyre. Kjo do të thotë se asnjë masë nuk është më e mirë se natyra e njeriut.

KUALITETET E LINDURA TË FEMRËS

Njeriu ekziston si shtazë spirituale, materiale dhe intelektuale duke i shtuar karakteristikat e tij personale dhe duke mos i harruar gjithashtu raportet e tij sociale. Prandaj, diskutimi i plotë mbi të drejtat e femrës duhet të përfshijë studimet e filozofisë, psikologjisë, sociologjisë dhe shkencave të tjera simotra. Përpjekja për sqarimin e çdonjërës prej këtyre shkencave do të kërkonte shumë kohë. Mirëpo, për ta kuptuar drejt diskutimin tonë, ka nevojë për disa sqarime të shkurtra.

Është e pamohueshme që edhe burri edhe gruaja janë qenie njerëzore. Gjithashtu, është e pamohueshme se te dy kanë veti dhe vlera të përbashkëta njerëzore. Mirëpo, kjo nuk mund të merret si bazë për matjen e dallimeve që ekzistojnë midis të drejtave dhe obligimeve të tyre.

Këto dallime ekzistojnë për shkak të karakteristikave të tyre specifike në bazë të të cilave mund të dallohen. Këtu duhen shqyrtuar dallimet e shprehura në strukturën fizike të mashkullit

dhe femrës. Me fjalë të tjera, duhet hulumtuar se ç'është thotë koncepti i gjinisë femërore dhe ç'është thelbi i saj. Dallimi më i shprehur midis mashkullit dhe femrës është gjinia e tyre. Natyrisht, ata dallohen për nga sistemet e tyre nervore, si dhe për nga sistemet e tjera, mirepo, studimi i këtyre dallimeve është në kompetencën e filozofisë. Nga pikëpamja psikologjike, mashkulli dhe femra dallojnë në masë të madhe. Femrat janë kryesisht më emotive, gjersa të mashkullit arsyeja dallon mbi emocionet. Ky dallim është i lidhur drejtpërdrejt me sistemet e tyre nervore dhe një test kritik, psikologjik dhe fiziologjik do ta dëshmonte këtë me sukses nga pikëpamja sociologjike; studimi i prezantimit të familjes si faktor i fuqishëm dhe roli që ajo luan në bashkimin e çiftit bashkëshortor duhet të nënkuptohet. Megjithatë, dallimi në gjini midis mashkullit dhe femrës duhet të pranohet si normale dhe të merret si faktor i dobët për caktimin e detyrave dhe të drejtave të tyre. Studimi i kujdesshëm do të dëshmojë se ky dallim mund ta përcaktojë mirë statusin e tyre social, të të drejtave dhe detyrave materiale. Mandej, edhe po të kërkoheshin dallimet e tjera në sistemet e tyre nervore, psikologjike dhe sistemet e tjera, ato janë pa kurrëfarë teprimi, të rrënjësura në këtë dallim esencial. Midis femrës dhe mashkullit ekziston dashuria dhe simpatia e ndërsjelltë. Joshja e fuqishme reciproke seksuale dhe kënaqësitë, të cilat e përcjellin atë, ndihmojnë forcimin, ekzistencën e bashkësisë së tyre martesore, duke i mundësuar natyrës që ta arrijë qëllimin e vet, d.m.th. e njerëzimit. Megjithatë, mashkulli dhe femra nuk luajnë rol të njëjtë në realizimin e këtij qëllimi.

Për shembull, mashkulli, në masë të konsiderueshme, ka një shkallë të caktuar të lirisë në marrëdhëniet seksuale (p. sh. ai nuk mund të detyrohet të ketë marrëdhënie seksuale) gjersa te femra është e kundërta. Mirëpo, në anën tjetër, roli reprodutiv i mashkullit është momental, gjersa femra duhet ta mbajë barrën e shtatëzanisë nëntë muaj. Nëse kësaj ia shtojmë kohën që i nevojitet për ushqimin, përkuj-desjen dhe rritjen e fëmijës, atëherë do të kuptojmë se roli i saj është shumë më delikat në rritjen e pasardhësve. Me të vërtetë është për çudi, që një përfaqësuese mendjelehtë në senatin e një shteti pati deklaruar: *“Lindja e fëmijës është gjëja më e lehtë që i ndodh femrës nga natyra. Kjo është njësoj sikur mashkulli të bëjë një hap të vogël për të kënaqur nevojat e veta.”* Mirëpo, siç e dimë, shtatëzania dhe lindja janë detyra të nderëshme të vështira, sepse kërkojnë shumë kohë dhe janë të rëndësishme, prandaj nuk do të duheshin krahasuar në asnjë mënyrë me aktivitetin e përditshëm, e as të minimizohen, siç bën femra e përme-ndur e senatit. Femra shtatëzënë duhet të ballafaqohet me shëndetin e dobësuar dhe problemet që përcjellin shtatëza- ninë, prandaj për këtë arsye i nevojitet pushimi dhe trajtimi medicinal si për ndonjë të sëmurë. Siç deklarojnë mjekët, periudha e shtatëzanisë është e ngjashme me sëmurjen. Çdo gjë tjetër varet nga përgatitja e mirë fizike dhe mentale, gjersa njëkohësisht preferohet largimi nga nevrokosja, shqetësimi dhe lodhja. Mospërfillja e kësaj këshille mund të jetë e dëmshme për nënën dhe fetusin. Lindja e fëmijës duhet të respektohet gjithsesi. Natyrisht, lindjes i paraprijnë vështirësitë shëndetësore dhe ajo

përcillet me dhembje, shëndet të dobësuar dhe dukuri të tjera përcjellëse. Pastaj, është e ditur se në javët e para pas lindjes femra ka nevojë për pushim për t'iu rikthyer gjendjes normale shëndetësore.

Tani u bë i qartë shkaku përse Kur'ani femrën e ka liruar nga aktivitetet fizike. Ne nuk kemi ndërmend të diskutojmë në kundërshtim me këtë. Në realitet, ne vetëm dëshirojmë të theksojmë rëndësinë e rolit riproduktiv të femrës. Kjo do të thotë se roli i mashkullit në procesin riproduktiv nuk mund të krahasohet me atë të femrës, e cila i nënshtrohet periudhës së gjatë të shtatëzanisë, dhembjeve të lindjes dhe vuajtjeve të tjera që shoqërojnë këtë gjendje. Prandaj, duhet të dallohet roli natyror dhe i lindur, si dhe detyrat e femrës në shoqëri dhe të hulumtohet përse është e paji- sur me veçori të tilla natyrore dhe cilat janë nevojat dhe mundësitë natyrore të saj. Pasi barra e lindjes bie vetëm mbi femrën, Allahu i Madhëruar xh. sh. e ka pajisur me qëndrueshmëri të mjaftueshme për ta realizuar këtë detyrë me rëndësi, dhe njëkohësisht të provojë kënaqësi gjatë kryerjes së këtij akti. Kjo dhuratë e Allahut xh.sh. është fuqia shpirtërore e dashurisë së nënës; nuk ka dyshim që për mashkullin do të ishte fare e padurueshme sikur të ishte i detyruar të mbante barrën e maternitetit. Ndërsa kjo është aspirata më e lartë e femrës, andaj ekzistojnë shumë femra sterile të cilat janë në gjendje të shpenzojnë sasi të mëdha parash për t'u mbarsuar në mënyrë medicinale. Zakonisht, për mashkullin paraqet kënaqësi që të ketë fëmijë, mirëpo a (sa) është ai i gatshëm të kacafytet me probleme

të caktua-ra për hir të fëmijes, siç është e gatshme femra? A është ai i gatshëm ta pastrojë fëmijën e vockël me atë butësi siç e bën këtë femra? A do të flijonte pushimin, rehatimin dhe kohën e lirë për shkak të fëmijës, ose, çka është akoma më me rëndësi, a do të ndiente kënaqësi duke i kryer këto detyra të mundimshme dhe të vështira?

Edhe nëse hasim ndonjë mashkull të tillë, ai do të jetë nga të rrallët. Dhe, siç e dimë, në suaza të rregullativës sociale, këto përjashtime nuk mund të pranohen. Përveç kësaj, qëndrimet e mashkullit dhe të femrës mbi rritjen e fëmijëve në esencë dallojnë. A mund të pohojmë me të drejtë se te dyt gjithnjë shprehin afinitet të njëjtë natyror ndaj detyrës së rritjes së fëmijës dhe diçka të ngjashme? Me këtë rast mund të themi se dallimet psikofizike midis mashkullit dhe femrës janë përcaktuar shumë mirë. Mashkulli zakonisht është më eksploziv, kurse kjo veçori është në kundërshtim me kuptimin e maternitetit dhe kujdesit. Përkundër kësaj, femra është më e hareshme dhe më zemërbutë në ndjenjat e saj dhe dashurinë amnore, e cila mund të konsiderohet si burim kryesor i emocioneve të saj, por dhe forcën bartëse me të cilën ajo i pranon këto detyra të rënda dhe prej të cilave formon ideale jetësore.

Këtu duhet theksuar se do të ishte gabim të diskutohet (të merret në shqyrtim konstitucioni fizik dhe psikologjik) lidhur me atë se mashkulli duhet të mbajë barrën e njëjtë të detyrave amnore si dhe femra (këto detyra konsiderohen më të ndershme për femrën dhe janë faktorë vendimtarë për vashdimësinë e

ekzistencës njerëzore). Gjithashtu, nuk mund të diskutohet as për atë që femra duhet të marrë pjesë dhe të veprojë krah për krah me mashkullin në detyra të caktuara, të cilat janë të dedikuara dhe të krijuara posaçërisht për të. Ky realitet vjen edhe më shumë në shprehje pas analizës së anatomisë së mashkullit. Kjo analizë tregon se sistemi (aparatin) i krijimit është të konstituuar dhe konstruktuar që ai të mund të kryejë disa detyra të caktuara. Për këtë do të diskutojmë më vonë.

Filozofët dhe anatomistët gjithashtu kanë theksuar dallimet të cilat ekzistojnë në sistemet autonome nervore të mashkullit dhe femrës. Për shembull, është konstatuar në mënyrë anatomike se truri i mashkullit është më i madh dhe mesatarisht 100 gramë më i rëndë se ai i femrës. Gjithashtu, pjesa e përparme e trurit të femrës është më se 50 cm më i vogël se te mashkulli. Përveç kësaj, me analizën e pjesëve përbërëse të trurit të dy gjinive, fiziologët kanë konstatuar se truri i mashkullit në aspektin anatomik dallohet nga ai i femrës me shprehjen e shenjave të intelegjencës dhe të zhvillimit mental superior.

Këto ishin disa nga dallimet më të rëndësishme midis mashkullit të zakonshëm dhe femrës së zakonshme. Përjashtime mund të ketë, si p.sh: në rastet kur konstatohet se truri i femrës është më i madh se ai i mashkullit. Mirëpo, siç theksuam më sipër, rastet e tilla mund të komentohen me përjashtimet për të cilat u bë fjalë.

Faktorët kryesor që ndikojnë në formimin e familjes, deri tani, sa na ka lejuar shtrirja e këtij diskutimi, kemi sqaruar dallimet më të shprehura strukturale midis dy gjinive, qofshin ato fizike apo psikologjike, me lidhshmëri direkte të së kaluarës me të ardhmen. Tani arrijmë në pikën e tretë, respektivisht, në simpatinë natyrore midis gjinive dhe formimit të familjes. Është fakt i pamohueshëm që mashkulli gjatë jetës së tij ndien nevojë të vazhdueshme për bashkëpunim dhe mbështetje nga të afërmit e vet, në atë masë sa është i nderuar me atë që është krijuar si shtazë sociale. Kjo karakteristikë gjithsesi ka qenë vendimtare në formimin e shoqërive njerëzore të cilat ekzistojnë me vite. Mirëpo, a mund të jetë kjo nevojë e bashkëpunimit për shkak të ekzistencës, për shkak të mbrojtjes nga armiku dhe për zhvillimin e ekonomisë faktor themelor për formimin e familjes? Apo do të duhej flakur ky pohim?

A është ky faktori i njëjtë që e nxit mashkullin të bashkëpunojë me të afërmit dhe që i shpie dz gjinitë në lidhje për shkak të formimit të familjes? Me fjalë të tjera, a është edhe bashkimi më autentik dhe i natyrshëm njerëzor rezultat i nevojave të mashkullit për para, për mbrojtje të ngjashme, ose, mbi të gjitha, a është rezultat i simpatisë së dyanshme seksuale, që manifestohet në mënyrë të natyrshme te të dy gjinitë dhe dashurisë ndaj fëmijëve, të cilët janë faktorë aktual para formimit të familjes?

Thua Krijuesi, i Cili krijoi mashkullin dhe femrën ashtu që të ndiejnë simpati të ndërsjelltë njëri ndaj tjetrit (kjo ndjenjë ka ndikim të madh në jetën tonë, është ndjenjë dominuese mbi të gjitha ndjenjat dhe është ndër fuqitë më të forta të natyrës), nuk e ka përcaktuar këtë simpati si forcë aktive për formimin e njësisë sociale të quajtur familje?

Siç është theksuar më lart, barazia e cila karakterizon dy qenie nuk mund të merret si shkas për rastin e femrës. Mandej, nëse bashkëpunimi mes dy personave shpie drejt formimit të familjes, atëherë edhe dy persona të një gjinie do të mund të krijojnë familje konform parimeve të barazisë dhe bashkëpunimit grupor. Nevoja për bashkëpunim e perso-nave të dy gjinive nuk do të paraqi- tej meqë formimi i familjes kryesisht kushtëzon një bashkim të tillë në të cilën ekziston një lidhje e pandërprerë midis tyre.

Për këtë arsye, analiza e qenies natyrore njerëzore të mashkullit dhe femrës duke marrë parasysh instiktin seksual, botën e natyrshme shpirtërore, mirëqënien dhe kënaqësinë e udhëheqjes së jetës familjare dhe marrëdhënies origjinale martesore nuk do të lërë kurrfarë dyshimesh se familja është bazuar me këtë simpati reciproke midis tyre.

NDIKIMI I NATYRËS NË PËRCAKTIMIN E ROLIT SHOQËROR TË FEMRËS

Natyra e njeriut dhe karakteristikat e përbashkëta për të dy gjinitë do të ishin të parëndësishme nëse ndonjë qenie njerëzore do të privohej nga disa të drejta elementare, të drejta të natyrshme, autentike dhe të lindura. Disa nga këto të drejta janë: e drejta për pavarësinë, e drejta e mendimit dhe e veprimit të lirë, e drejta për pronë, e drejta e drejtësisë së barabartë, e drejta për mbrojtjen e të drejtave legjitime etj.

Asnjë personi nuk mund t'i mohohen këto të drejta në bazë të natyrës, gjinisë, pozitës, kombësisë ose shkallës së arsimit. Të gjithë do të duhej t'i gëzojnë këto të drejta njësoj, pa marrë parasysh a është i bardhë ose i zi, mashkull ose femër, sundues ose i nënshtruar, i Lindjes ose i Perëndi-mit, qytetar ose fshatar, i arsimuar ose i paarsimuar. Pran-daj, rregullat dominuese në civilizimet antike duke proklamuar lehtësime sociale, duke dhuruar të drejta për pronësi, liri dhe arsimim dhe të drejta të tjera materiale dhe intelektuale vetëm për shtresat udhëheqëse, ose atyre civili-zemeve në të cilat femra është konsideruar skllave e zakonshme dhe pronë ekskluzive e mashkullit, edhe në këtë botë edhe në botën tjetër, janë në kundërshtim me natyrën njerëzore.

Fatkeqësisht, madje edhe sot, në disa vende perëndimore të cilat shumë njerëz i shikojnë si civilizime të përsosura, mund të hasen mbetje të këtyre rregullave anti-humane. Shembull eklatant është diskriminimi aktual kundër zezakëve vetëm për arsye të

ngjyrës së tyre të lëkurës.

Natyrisht, ekzistojnë edhe ata që nga lindja posedojnë kualitete superiore dhe veti specifike dhe, kur ballafaqohemi me këtë, kjo nuk duhet lënë pasdore. Po kjo ndodh edhe me dallimet që ekzistojnë në konstitutionin fizik dhe biolo-gjik të mashkullit dhe femrës. Në realitet, në regjistrin e të drejtave sociale, ky faktor do duhej të shqyrtohej seriozisht.

Për shembull, pas mbetjes me barrë, femra në bazë të konstitutionit të saj fizik bëhet e gatshme për ushqimin e fëmijës së saj. Asnjë ligj nuk mund t'ia mohojë këtë të drejtë. Nëse ndonjë ligj vendos që babai ka të drejtë që fëmijën e vet t'ia japë në gji kujt të dëshirojë, atëhere ky ligj do të ishte në kundërshtim me natyrën e njeriut. Gjithashtu, nëse ligji vërteton se femra duhet të shkojë në luftë për të luftuar dhe mbrojtur vendin nga armiku, ky ligj do të ishte në kundërshtim me natyrën e njeriut, ngase mashkulli është nga lindja i pajisur me fuqi më të madhe fizike, është më i fortë mentalisht dhe, për këtë arsye, është më i përshtatshëm për luftë se femra.

Në bazë të kësaj, sa i përket femrës, duhet të analizohet nevoja e konstitutionit të saj natyror në lidhje me rregullat sociale. Natyra i ka dhuruar emocione të posaçme dashuri amnore, e cila është sigurisht njëra nga kualitetet e lindura. Roli aq me rëndësi që luajnë emocionet në shoqër-inë njerëzore, ndikimi i tyre i konsiderueshëm për rritjen e fëmijës dhe ndjenjat njerëzore që nxiten në qenien e njomë janë temë për diskutim. Fatkeqësisht,

vëllimi i kufizuar i këtij diskutimi nuk na lejon ta bëjmë këtë. Ne do të kënaqemi vetëm duke përkujtuar se shumë ithtarë të marrëdhënieve të lira seksuale tash po e braktisin këtë filozofi të çmendur dhe të çoroditur duke parë rezultatet e saj në numrin e madh të pasardhësve jashtëmartesor, të cilët janë privuar nga dashuria amnore dhe nga ndjenjat e vërteta njerëzore, gjatë rritjes, të cilat janë e drejtë e patjetërsueshme.

Për këtë arsye, kur të formulohen ligjet dhe rregullat që i përkasin gjinisë femrore, duhet gjithnjë të kihet parasysh se ato nuk duhet të jenë në kontradiktë me detyrat e ndershme të maternitetit ose të mos jenë largndjenjave të lindu-ra të femrës, të cilat i janë dhuruar nga Zoti.

Përveç kësaj, hulumtimet kanë dëshmuar, pa kurrfarë dyshimi, se shoqëria e bazuar në sistemin e familjes është më e natyrshme dhe më autentike se të gjitha shoqëritë. Kjo shoqëri është rezultat i simpatisë së natyrshme që provojnë të dy gjinitë njëra ndaj tjetrës.

Çdo ligj në kundërshtim me këtë rend natyror do të ishte johuman, i dëmshëm për shoqërinë dhe represiv ndaj femrës dhe tërë llojit njerëzor.

Një moment që meriton vëmendje është ai që aqsa është femra më sensible se mashkulli në lindje, aq është ai më i fuqishëm në aspektin fizik dhe mental. Ky dallim është i mundshëm nga evolucioni i shoqërisë njerëzore. Hulumti-met voluminoze të filozofisë dëshmojnë se ky superioritet është i pamohueshëm.

Prandaj, detyrat e caktuara në harmoni me strukturën fiziologjike dhe mentale të mashkullit, siç është lufta, e cila kërkon shumë guxim, duhet të rezervohen për të, pa marrë parasysh a sjellin kënaqësi ose dhembje. Vërtetë, kjo do të duhej të prosperonte llojin njerëzor në tërësi dhe do të ishte në harmoni me rendin natyror.

FEMRA NË ISLAM

Para se t'i qasemi këtij shqyrtimi, duhen përmendur disa gjëra:

1. Për të kuptuar drejt bazat e Islamit duhen bërë hulumtime të themelta dhe të kujdesshme bazuara në kriteret kur'- anore, në kriteret e Pejgamberit të Zotit, Muhammedit s. a. v. s. të transmetuesve shembullor; dhe në veprimet e tyre jetësore, që bëhen imperativ yni.

Gjithashtu, do të ishte gabim të pohohet se Islami ka lënë pas dore të drejtat legjitime të femrës, duke dëgjuar ose e vërejtur këtë diku ose në një periudhë të caktuar, kur muslimanët ia kanë mohuar femrës të drejtat e saj legjiti-me. Kur dikush vëren se dispozitat islame mohohen në ndonjërin nga vendet muslimane, të cilët më me dëshirë kopjojnë kulturat perëndimore, nuk mund të përfundoj se ligjet ekzistuese janë në pajtim me Islamit, madje edhe nëse miliona muslimanë e ndjekin këtë orientim properë-ndimor.

Në anën tjetër, prapësitë e shfaqura aq shpesh nga konceptet

ekstremiste dhe të gabuara perëndimore nuk mund t'i përshkruhen fesë së Isait a.s. Ne e dimë se disa sekte të krishtera kon- siderojnë se femra nuk është qenie e plotë njerëzore, dhe se ajo është urë lidhëse ndërmjet shtazëve dhe njerëzimit, që shpirti i saj (në përjashtim të Mejremes r.a.) nuk është i përjetshëm dhe se shpëtimi i amshueshëm është e drejtë ekzekutive e mashkullit. Këto koncepte, të cilat i numëruam deri tani, nuk mund t'i përshkruhen mësi-meve të Isait a.s., e gjithashtu do të ishte krejtësisht gabim të lidhet korrupsioni ekzistues dhe prostitucioni në botën perëndimore me Krishterizimin në tërësi.

2. Ligjet civile dhe penale janë bërë sipas masës së qytetarit të zakonshëm, normal, dhe përjashtimet këtu nuk kanë vend. Në realitet ekzistojnë fare pak dispozita konstytucionale të bazuara në përjashtime. Prandaj, nëse paraqiten raste të tilla në kundërshtim me ligjet ekzistuese, këto ligje nuk mund të shpallen të pavlefshme. Nuk mund të aku-zohet ligdhënësi në raste të paraqitjes së rasteve të tilla.

3. Ligjet dhe rregullat fetare jo vetëm që sigurojnë rend në shoqëri dhe mbrojnë interesat e saj materiale, por, gjithashtu, mbështesin aspektet shpirtërore intelektuale. Do të ishte gabim të mendohej se vërejtjet dhe ndalesat kanë të bëjnë vetëm me interesat laike. Në të vërtetë, si mundet dikush të mendojë se Ligdhënësi Famëlartë, Allahu Fuqiplotë, i Cili i ka kushtuar rëndësi të madhe shpëtimin të amshueshëm të njeriut dhe që aq mirë e ka paraqitur frymën e Teuhidit (njësisë së Zotit) dhe

adhurimit të Zotit në të gjitha manifestimet e jetës, e ka lënë pas dore aspektin shpirtëror duke i dhënë rëndësi posaçërisht asaj që është materiale? Mirëpo, kjo nuk do të thotë se në mësimet dhe dispozitat fetare të kësaj feje të përsosur të Zotit materia duhet të eliminohet tërësisht. Njëmend, si mund të besojë dikush se Allahu xh. sh., Ligjdhënësi Fuqiptotë, i Cili ka vendosur balancim të përkryer mes trupit dhe shpirtit, ka përmbushur qëllimin e krijimit dhe këtë botë e ka bërë arë në të cilën njeriu e mbjell farën e jetës së tij të amshueshme dhe korr frytet në botën tjetër konform veprave dhe besimit në këtë botë, mund të ketë lënë pas dore aspektet materiale në mësimin e këtij besimi?!

Vazhdimisht duhet të kemi ndër mend se Zoti e krijoi njeriun në këtë botë për ta arritur idealin për të cilin është përcaktuar në zhvillimin evolutiv të jetës së tij. Jeta e përbotshme e njeriut është bazë për jetën e tij të amshueshme, jetën e shpëtimit dhe dënimit.

Legjislacioni hyjnor e udhëzon njeriun gjatë jetës së tij që të kuptojë rrugën e drejtë në dritën e këshillës së Zotit, në mënyrë që, duke ecur nëpër këtë rrugë të ndritshme të Zotit, të arrijë në cakun ideal. Njeriu në mënyrë instiktive si shtaza detyrohet të dallojë të mirën nga e keqja. Kjo e shpjegon nevojën e tij për legjislacionin hyjnor.

Prandaj, instiktet njerëzore nuk i ndihmojnë atij të dallojë të drejtën nga e gabuara në këtë botë (jeta mallëngjyese në këtë

dhe në botën tjetër). Mendja e tij gjithashtu kërkon të përmbushë këtë domethënie të krijimit. Trupi i njeriut, i kufizuar në kapacitetin e vet, nuk mund t'i parashikojë të gjitha gjërat që sjellin shpëtim - konkretisht shpëtim në botën e ardhshme, jetën e amshueshme. Duke mos e njohur akoma botën e ardhshme mendja e njeriut nuk mund të kuptojë rëndësinë e botës tjetër ose pengesat në rrugë për shpëtimin e amshueshëm. Për këtë arsye, njeriu gjatë jetës së tij shpesh nuk arrin të dallojë të mirën dhe të keqen, duke privuar veten nga drejtimi i veprave të veta drejt shpëtimit të amshueshëm. Për këtë arsye, ai ka nevojë për Shpalljen e Zotit, nga Ai i Cili ka pushtet mbi të gjitha jetët dhe gjërat dhe që i njeh hyrjet dhe daljet e aparatit për krijim.

Kështu, krijimi i Zotit dhe ligjislacioni hyjnor kanë qëllime të njëjta. I pari plotëson të dytin. Është e qartë se krijuesi i njeriut, që ka vendosur në rrugën e Zotit në natyrë përmes udhëheqjes dhe këshillave mbi krijimin dhe legjislacionin e Zotit, në mënyrë që ky ta arrijë idealin, këtë e bën për hir të progresit dhe mirëqenies së njeriut. Ai është Një dhe i Vetëm, Ai di çdo gjë dhe sheh çdo gjë pa dallim a është në lidhje me materien, shpirtin ose botën tjetër.

A ekziston dikush përveç Zotit, Një, dhe të Vetëm, që sheh çdo gjë dhe që mund të sajojë rregulla të cilat orientojnë jetën e njeriut në mënyrë aq të plotë, saqë mbulon të gjitha aspektet, qoftë materiale ose shpirtërore? Pra, mund të konstatojmë se Muhammedit a. s. v. s., vulës së të gjithë Pejgamberëve të Zotit,

i është dërguar shpallja e Zotit, të cilën ai ia ka transmetuar njerëzimit në mënyrë që edhe pasardhësit (umeti) përmes udhëzimit të Zotit të arrijnë gjendjen e përsosjes dhe mirëqënien në të dy botët dhe kjo shpallje nuk do t'i largojë kurrë nga rruga e drejtë. Prandaj, çdo njeri që e konsideron veten musliman dhe që beson se ligjet dhe këshillat islame janë jo të plota dhe të pamjaftue-shme karshi nevojave sociale, ose se kanë të bëjnë vetëm me një kohë apo vend të caktuar, definitivisht është i pa-informuar për bazat e Islamit ose nuk ka mençuri për t'i kuptuar ato.

4. Me mendime dhe pikëpamje kontradiktore që nga zanafilla e historisë njerëzore dhe përparësi të vazhdueshme në disa fusha të diturisë, dimë se idealin, stadiu më të lartë të përsosmërisë, njeriu nuk e ka arritur akoma. Në asnjë periudhë kohore, në asnjë vend, ai nuk ka qenë i aftë të kuptojë tërë misterin dhe të vërtetat e krijimit. Edhe sot shkencëtarët janë të hutuar nga shumë mistere dhe realitete të krijimit që ende nuk kanë arritur t'i zgjidhin. Dhe askush, që është i logjikshëm, nuk mund të na bindëse njeriu nuk do të gjejë sërish fusha të reja të diturisë. Disa, në mënyrë të arsyeshme, kanë pohuar se njeriu i shekullit atomik i ka zgjidhur të gjitha misteret e krijimit. Megjithatë, ka kaluar shumë kohë prej kur e kanë të qartë se pohimet e tyre ishin të pabaza.

Nuk mund të presim të kuptojmë të gjitha misteret e krijimit, ashtu siç nuk mund të kuptojmë qenien misterioze të njeriut. Sigurisht nuk mund të presim të kuptojmë sistemin e

ndërlikuar të legjislacionit hyjnor në raport me aspektet materiale, fizike, intelektuale dhe aspektet e tjera laike.

Pa dyshim, misteret e reja do t'i njohë njeriu i ardhmërisë në mënyrë të njëjtë siç i ka njohur njeriu bashkëkohor misteret e panjohura nga shekujt e kaluar. Por, megjithatë, ekzistojnë mistere të cilat njeriu duhet t'i ndriçojë edhe ata që e kalojnë botëkuptimin e tij.

5. Mbetet fakti që koleksioni i paçmueshëm i mësimëve islame, bindjeve përmbledhëse, rregullave morale, individuale dhe shoqërore është një elektuarium i cili shëron dhimbjet dhe ligështimin e shoqërisë dhe siguron shpëtim për njeriun në këtë dhe në botën tjetër. Megjithatë, nuk duhet përfunduar se vërejtjet dhe dispozitat islame vetve-tiu, me çdo kusht, do të sjellin rezultate ideale. Prandaj, deklaratat e tipit “Kjo dispozitë islame është anakronike për kohën tonë bashkëkohore”, duhet të braktisen.

Faktori i kohës nuk mund t'i dedikohet dispozitave islame dhe ato nuk mund të konsiderohen jo të plota.

Hulumtimi i kujdesshëm do të tregojë se nëse dispozita islame tregohet joefikase (nëse mund të jetë e tillë), atë-herë është peng i mospërfilljes së dispozitave të tjera isla-me, arsimimit të pamjaftueshëm fetar, ndasive morale dhe shpirtërore në shoqërinë tonë bashkëkohore, e jo se ligjet isla- me janë jo të plota ose janë të kufizuara në një periudhë ose vend të caktuar.

Sa i përket pozitës së femrës në Islam, duhet theksuar se Islami

femrën e konsideron si pjesëtare të pavarur dhe shembullore të shoqërisë dhe nuk bën kurrfarë dallimi në vlerat njerëzore midis mashkullit dhe femrës.

Islami dëshmon se shpëtimi mund të arrihet vetëm me devocion, punë, dituri dhe vepra të mira, ose siç thotë Kur'ani Famëllartë:

“O njerëz, Ne ju krijojmë prej një mashkulli dhe një femre dhe ju ndajmë në popuj e fise në mënyrë që të njiheni. Më i nderuari para Allahut është ai i cili ka shumë frikë nga Ai. Allahu, më të vërtetë, di çdo gjë dhe nga Ai nuk mund të fshehim asgjë.” (49:13)

“Dhe asnjëri prej jush mundin e tij nuk mund t'ia zhblerësojnë as mashkullit as femrës - ju jeni njëri nga tjetri.” (3:195)

Pra, Islami nuk bën dallim midis mashkullit të devotshëm dhe të bindur dhe femrës që posedon po këto kualitete. Në shoqërinë islame femra ka të drejtë të pose-dojë dhe të shesë pasuri, të trashëgojë, të arsimohet dhe të merret me tregti legjitime. Në kohën e Pejgamberit të Zotit, Muhammedit s.a.v.s., ka ekzistuar një femër e quajtur me emrin Zejnebe 'Attaare, e cila ka shitur parfume dhe Pejga-mberi i Zotit ka qenë njëri nga blerësit e saj. Në Islam, femra gjithashtu mund të jetë pjesëmarrëse në aktivitete shoqërore në atë masë sa pjesëmarrja e saj të jetë në pajtim me fuqinë dhe shembëlltyrën e saj:

“Ju nuk jeni përgjegjës për atë të cilën ato, në harmoni me ligjin, e bëjnë vetë.” (2:234)

Në Islamin e hershëm femrat i bashkangjiteshin luftëtarëve muslimanë në fushbeteja dhe ndihmonin në përgatitjen e ushqimit, mjekimin e të plagosurve etj. Njëmend, në Islam ekzistojnë dallime të caktuara midis të drejtave dhe detyrave të të dy gjinive. Për shembull, vetëm mashkulli mund të marrë pjesë në administratën legislative, në pushtet dhe në xhihad. Gjithashtu, pjesa trashëgimore e femrës është përgjysëm më e vogël se e mashkullit. E drejta për shkurorezim dhe për poligami, në rrethanat e caktuara, i përket vetëm mashkullit. Femra duhet të respektojë bashkëshortin e saj në marrëdhëniet bashkëshortore dhe ky është shkak që ajo nuk duhet të dalë nga shtëpia pa lejen e tij.

Mashkulli, nga ana e tij, duhet ta mbështesë bashkëshorten e vet dhe ta furnizojë më gjërat e nevojshme për jetë në pajtim me mundësitë materiale. Madje, në disa raste, Islami lejon, nëse paraqitet nevoja, që mashkulli të punësojë ndonjë shërbëtoare e cila do t'a ndihmonte atë. Në Islam, obligimet e punëve të shtëpisë, siç janë larja, zierja, pastrimi, madje edhe rritja e fëmijëve nuk i bien hise vetëm femrës, pasi ajo mund të kërkojë dëmshpërblim për këto punë nga bashkëshorti i saj.

Të gjitha këto Islami i pranon si legale, në anën tjetër, kur zbatohet mësimi fetar dhe moraliteti Islam, familja jeton në mirëqenie, kënaqësi, respekt, dashuri reciproke, disponim dhe sinqeritet. Natyrisht, edhe në ato familje të formuara në harmoni me dispozitat dhe vlerat islame, rastet e rralla të grindjes janë të pashmangshme.

Le të shikojmë se a është Islami në kundërshtim me rendin natyror, kur bën dallim midis mashkullit dhe femrës dhe sa larg arrihen të drejtat e tyre. Siç u tha më herët, të kuptuarit e drejtë e këtyre problemeve kërkon të kuptuarit e drejtë të nevojave të të dy gjinive dhe dispozitave të caktuara në aspektin e të drejtave dhe detyrave të tyre. Mirëpo, faktori i kohës nuk na lejon sqarimin në detaje të kësaj çështje. Prandaj, do të kënaqemi vetëm me arsyetim të shkurtër, me shpresë se në të ardhmën do ta prezantojmë si diskutim të elaboruar.

Siç kanë dëshmuar përvojat e përbashkëta, mashkulli në planin fizik dhe intelektual është superior në krahasim me femrën, ndërsa ajo është më emocionale. Në bazë të kësaj, punët që kërkojnë më shumë inteligjencë, edhe kur emocionet paraqesin pengesa, në pajtim me rendin natyror, duhet t'i ndahen mashkullit. Kjo duhet të jetë kështu ngase sunduesit dhe gjyqtarët janë ata të cilët duhet t'i mbrojnë të drejtat e të gjitha shtresave shoqërore. Nëse lejohet që emocionet të depërtojnë në pushtet dhe legjislacion, atëherë të drejtat e shumë femrave do të nëpërkëmbshin nga ana e parisë në pushtet. Pra, legjislacioni duhet të veprojë nga pozita në të cilin shkaqet do të dominonin mbi emocionet. Mirëpo, nuk mund të konkludohet se vetëm faktori i të qenurit mashkull duhet të jetë masë ekskuzive për sundim dhe kryerje të detyrës së gjyqtarit. Për këtë duhet të përmbushën edhe disa kushte të tjera, të cilat i parasheh Islami.

Në realitet, ne dëshirojmë të deklarojmë, duke pasur parasysh të dy gjinitë, se mashkulli është i lindur, nga natyra, për disa

aktivitete të caktuara. Prandaj, kur Islami bën këso dallimesh midis tyre kurrë nuk mund të thuhet se është represiv ndaj femrës dhe se është përçmues ndaj vlerave dhe dinjitetit të saj. Gjithashtu, duhet të kuptohet drejt kur Islami e fton mashkullin që të jetë ushqyes i familjes ose luftëtar. Mashkulli nuk mund ta marrë këtë gjë si represion ndaj pozitës dhe vlerave të tij. Këto dispozita islame janë orientuar drejt forcimit të bashkëpunimit dhe ndihmës së ndërsjellë në dobi të rendit dhe interesit shoqëror përmes përdorimit të drejtë të dhuratave të Zotit për të gjithë njerëzimin, pa marrë parasysh gjininë.

Meqënëse mashkulli është superior, edhe fizikisht edhe mentalisht, ai duhet të kryejë aktivitetet shoqërore konform këtyre kualiteteve të përmendura, gjersa femra, meqë është më emocionale, duhet t'i kryejë detyrat e mirëmbajtjes së shtëpisë dhe të kujdeset rreth fëmijëve në mënyrë që të rrisë fëmijë të devotshëm dhe të dëgjueshëm.

Siç u përmend, Krijuesi Fuqiplotë, në bazë të qëndrimit se familja është bërthama e shoqërisë, na ka pajisur me parakushte për themelimin e saj. Për shembull, simpatia natyrore seksuale i bashkon të dy në një shoqëri të amshue-shme (martesë) në të cilën dominojnë paqja dhe lumturia.

Familja, gjithashtu, nxit atë natyrë të lindur, dashurinë konkrete natyrore që ndien çdo qenie njerëzore ndaj pasardhësve të vet. Feja e ndritur, Islami, konsideron se jeta familjare ka rëndësi të madhe. Në Islam femra siguron mirëqenien shoqërore, lumturinë

dhe dashurinë reciproke mi-dis çifteve, që është në pajtim me rendin natyror.

“Dhe njëri nga argumentet e Tij është që për ju, nga lloji juaj, krijon femrën për t’u qetësuar pranë tyre, dhe se midis jush vendos dashuri dhe mëshirë.” (30:21)

Ky ajet e bë më të fortë harmoninë midis ligdhënësit hyjnor të rendit natyror të krijimit dhe natyrës së njeriut. Tani duhet shikuar se cilat ligje janë konstruktuar në lidhje me nevojat dhe kërkesat familjare.

Rëndësia jetike e shoqërisë familjare mund të kuptohet përmes përsiatjes në bazë të ajeteve kur'anore, vlefshmë-rinë e të cilëve e kanë argumentuar dhe vërtetuar shumë shkencëtarë e sociolog.

Familja, e cila përbëhet prej dy elementeve përbërëse, mashkullit dhe femrës, fton për bashkëpunim reciprok dhe siguron nevojat e tyre. Realisht, ata së bashku formojnë një organizëm, duke i mundësuar përmes së njerëzimit të zhvillohet dhe në fund të sillen fryte. Pra, përmes bashkëpunimit, çifti bashkëshortor mund të rrisë dhe të arsimojë farën e frytit të vet.

Nuk ka dyshim se roli natyror i mashkullit në procesin e riprodhimit dallon nga ai i femrës. Roli i tij është momental, ndërsa roli i saj është i rëndë dhe kërkon kohë. Femra e mbart këtë fryt nëntë muaj në trupin e vet, duke e ushqyer me lëngun e jetës së saj dhe pas lindjes së fëmijës, e pranon si jetën dhe shpirtin e vet personal, e ushqen dhe në mënyrë instiktive e flijon pushimin, rehatinë dhe qetësinë e vet për mirëqenien e tij.

Vërtetë, a nuk do të ishte represive ndaj femrës sikur ta privonim nga detyrat e rënda që i kërkon natyra e saj, apo ta ngarkonim me detyrat e rënda dhe të mundimshme të mashkullit? A e fton rendi natyror femrën të mos rrisë fëmij-ët e vet dhe të shkojë në luftë për ekzistencë? Çdo të bënte femra me gjinjtë e saj plot qumësht? Si do të pranojë të largohet nga fëmija e saj duke qenë dashuria dhe emoci-onet amnore mund të shkaktojnë çmendje në rast të një ndarje të tillë pikëlluese? A nuk duhet të jetë mashkulli ai që mban familjen në mënyrë që kështu t'ia kompenzojë femrës vuajtjet e rënda të mbetjes me barrë dhe të lindjes, të ushqimit dhe rritjes së fëmijëve dhe detyrave të tjera që i përkasin nënës? A duhet mashkulli të mendojë me ogoizëm për plotësimin e dëshirave seksuale dhe të harrojë çdo gjë mbi barrën e rëndë dhe detyrat e femrës? A mund të jetë i saktë pohimi se promiskuiteti seksual i femrës kinse mbytet të gjitha ndjenjat e saj amnore, meqenëse ajo e liron vetën me kënaqësi nga prangat natyrore dhe të lindura?

A mund të pohohet se kur fëmija ndahet nga dashuria e nënës, që është dhuratë e Zotit duke shndërruar familjen në bashkësi të ftohtë dhe të pajetë (siç ndodh shpesh në vendet perëndimore, posaçërisht në Amerikë), se kjo paraqet hap kryesor drejt përmirësimit të shoqërisë dhe sigurisë së të drejtave femërore? A mundet që aksionet e tilla, të cilat janë në kundërshtim me rendin natyror, të jenë në shërbim të shoqërisë?

Përgjigjet e këtyre pyetjeve mund të gjenden lehtë nëse shikohet mjerimi gjithnjë e më i madh, vuajtjet, vetëvrasjet, vrasjet mizore dhe vjedhjet në botën perëndimore. Sëmundje evidente, e botës së ashtuquajtur të civilizuar, është si rezultat i mungesës së qetësisë shpirtërore, mirëqenies dhe lumturisë në jetën familjare.

Siç thotë një orientalist i shquar: “Kënaqësia që provon muslimani duke puthur fëmijën e vet është e pakuptueshme për një njeri të Perëndimit, ngase në botën bashkëkohore vetëm një numër i vogël meshkujsh janë të sigurtë se fëmijet janë më të vërtetë të tyre.” Ai shton gjithashtu: “Unë nuk besoj se perëndimorët mund të lejojnë që popujt e Lindjes ta gëzojnë këtë privilegj. Është shumë e mundur se do ta marrim nga ata shumë shpejt.”

Ata që janë magjepsur nga bota e industrializuar perëndimore dhe që i lejojnë vetes të jenë mbartës të propagandës së tyre helmuese, të cilët Perëndimin ende e paramendojnë si parajsë dhe se çdo gjë perëndimore meri-ton vëmendje, lavdatë dhe imitim. Këta njerëz do të pendo-hen keq kur të kuptojnë se koncepti i tyre ka qenë i gabuar. Mirëpo, sidoqoftë, ky kuptim i hidhur u vjen tepër vonë, atëherë kur personi ose familja tashmë është shkatërruar.

Si qëndron puna sot kur, shumë shkencëtarë dhe mendimtarë perëndimorë kanë filluar ta shikojnë dëmin e shkaktuar nga këto koncepte të gabuara të jetës dhe të vlerave, prandaj po bëjnë përpjekje për ta zgjidhur këtë dilemë? Fatkeqësisht shoqëritë

perëndimore kanë arritur gjendje të pakthimtë në korrupsion dhe amoralitet.

Ja si deklaron një shkrimtar amerikan: “Për t'u mënjanuar këto probleme duhet rikonstruktuar dhe forcuar jeta familjare dhe duhet filluar sërish praktikimi i principeve dhe rregullave të dobishme që tashmë u kanë sjellë fat pjesëtarëve të familjeve dhe kombeve dhe që tashmë janë harruar. Femra duhet të jetë e dëgjueshme dhe duhet të respektojë bashkëshortin, ndërsa ky duhet ta dashurojë bashkëshorten e vet dhe t'i respektojë të drejtat e saj.”

Një anglez shkruan: “Dëshirojmë që vendi ynë të jetë si vendet muslimane, në të cilat atmosfera e dëlirësisë dhe e pastërtisë i ka përfshirë madje edhe robëreshat. Me të vërtetë, përse një atmosferë e tillë nuk ka filluar në shoqërinë tonë, në të cilën femra, sipas natyrës së saj, do të ishte përgjegjëse për punët shtëpiake, duke ia lënë punët e jashtme bashkëshortit, me çka do të ruante nderin e saj perso-nal?”

Për ata të cilët përkrahin kabaretë perëndimore dhe qendrat tona të korrupsionit dhe pohojnë se shkencëtarët si Pasteri, Edisoni dhe Ajnshtajni janë produkt i qendrave, preferojmë që vetëm sipërfaqësisht të shikojmë hulumtimet e paparagjykuara të disa studiuesve, shkencëtarëve, shkrimtarëve dhe botuesve perëndimorë. Duke bërë këtë, do të mund të kuptojn vlerën e mësimëve islame dhe nuk do ta flaknin një dhuratë aq të çmueshme të Zotit, siç është Islami.

Tani, kur është sqaruar se rregullat shoqërore do të duheshin formuluar për të qenë në harmoni me rendin natyror, bëhet e qartë se rritja e fëmijëve dhe punët e shtëpisë janë detyrat që i përkasin femrës. Nga ana tjetër, ato detyra të cilat janë në harmoni me konstitucionet natyrore të mashkullit siç është për shembull, mbajtja e familjes, duhet t'i përkasin atij. Sipas kësaj, familja që garanton edukim të mjaftueshëm të individualiteteve të devotshme do të shërbejë për këtë qëllim më së miri.

Kur kemi parasysh detyrat e të dy gjinive, do të shohim se hisja e mashkullit në porosinë e trashëgimit është më e madhe, gjë që është fare e drejtë. Tek e fundit, në realitet, ai këtë pasuri e ndan me femrën. Në lidhje me këtë, a mund të thuhet se Islami i rrënon të drejtat e femrës? Ne do t'ia lëjmë drejtësisë ti përgjigjet kësaj pyetje. Përveç kësaj, ne nuk do të harrojmë të theksojmë se mashkulli nuk është i krijuar vetëm për detyra materiale dhe seksuale. Gjithsesi, instikti seksual është njëri prej shumë sosh që i janë dhuruar natyrës njerëzore për arritjen e qëllimeve të caktuara, prandaj nuk bën të shkohet në ekstremizëm dhe të mohohet instikti seksual për shkak të përmbushjes së instikteve të tjera.

As nuk është e drejtë të diskreditohen të gjitha virtytet njerëzore dhe qëllimet më të larta të krijimit për të kënaqur instiktin seksual. Sot shumë bastardë seksual, me synimet e tyre të kota, për të kënaqur kërkesat e veta sadiste seksuale, luftojnë kinse për emancipimin dhe lirinë e femrës. Gjersa shikojnë fytyrat e zbuluara dhe të lyera të femrave dhe zhyten në marrëdhënie

ilegjitime johumane me to, qëllimi i tyre i vetëm është plotësimi i nevojave seksuale.

Mirëpo Islami, i cili gjërat i vështron nga të gjitha këndet e mundshme dhe njeh vetëm të vërtetën, duke e dalluar të mirën nga e keqja, ndalon prerazi dhënien pas epsheve dhe eksploatimin seksual të femrës, pasi kjo është e dëmsh-me për virtytet dhe familjen e njeriut.

Islami femrës i urdhëron të mbulohet prej kokës deri në zogun e këmbës, kur të dalë nga shtëpia dhe jashtë rrethit familjar (sipas mendimit të shumë juristëve islamikë, mbulimi i fytyrës dhe duarve më shumë se kyçi i dorës nuk është i domosdoshëm). Kjo bëhet me qëllim që trupi i saj të mbrohet nga shikimet e meshkujve, përveç burrit, ose farefisit të afërt me të cilët i është ndaluar martesja, siç janë vëllë-zërit, dajallarët etj. Femra jashtë rrethit të familjes, gjithashtu, nuk mund të mbarte stoli të fytyrës, ngase kjo i josh meshkujt dhe nuk mund të lëshohet me ta në lajka në asnjë mënyrë. Siç thotë Kur'ani Famëllartë:

“Dhe le t'i lëshojnë shamitë e tyre mbi krabarro-rin e vet; stolitë e veta të mos ia tregojnë të tjerëve.” (24:31)

“Mos tërbiqni vëmendjen me të folur, në mënyrë që të vijë në dilemë ai, zemra e të cilit është e sëmurë.” (33:32)

Islami, gjithashtu, të drejtën e shkurorëzimit ia jep vetëm mashkullit.

Në njëren anë, mbrojtja e familjes është me rëndësi jetike, ndërsa, në anën tjetër, ekzistojnë faktorë të cilët shkaktojnë mosmarrëveshje dhe grindje në familje, saqë për çiftin bashkëshortor jeta e përbashkët bëhet e padurueshme. Këtu shfaqet roli i kontratës martesore me kohë të kufi- zuara. Femra, meqenëse nga natyra është më emocionale dhe ofendohet lehtë, me siguri do ta përdorte gabimisht të drejtën e shkurorëzimit, nëse do ta kishte në dorë. E prekur nga ndonjë shkas trivial, jashtë ndjenjave, ajo do të mund ta rrëronte familjen me përdorimin e gabuar të kësaj të drejte.

Numri i shtuar i shkurorëzimeve në shoqërinë evropiane dhe amerikane është dëshmi e qartë për këtë fakt. Statistikat tregojnë se në Amerikë së paku njëra nga pesë marte-sat, përfundon me shkurorëzim dhe 80 përqind të kërkesave për prishjen e kurorës parashtrihen nga femrat, për shkaqe kryesisht të parëndësishme. Pra, mashkullit, si palë më e arsyeshme dhe më pak emotive, i është dhënë e drejta për prishjen e kurorës.

Aq më tepër, në Islam shkurorëzimi konsiderohet bar i hidhur, bar që nuk duhet të përdoret vetwm se në raste të skajshme, nën kondita të rënda dhe me respektimin e kujdesshëm të të drejtave të të dy palëve. Në anën tjetër, në ajetet kur'anore në lidhje me shkurorëzimin, Allahu Mëshirëbërës e porosit mashkullin prerazi duke i dhënë udhëzime, këshilla, vërejtje dhe kanosje që të mos e keq-përdor të drejtën:

“Kur t'i lëshoni gratë, para se të keni plotësuar afatin e tyre për pritje, atëherë ose i mbani me të mirë, ose i përcillni me bujari. Dhe mos i ndaloni për t'i dëmtuar; kurse që e bën këtë, e ka dëmtuar vetveten. Mos u lani me dispozitat e Allahut dhe kujtoni begatinë e Tij për ju, dhe librin me këshillat e shpallura për ju si udhërrëfim. Kini frikë Allahun, ngase Ai di çdo gjë - mos e harroni këtë!” (2:231).

Prandaj, nëse dikush keqpërdor të drejtën e shkurorëzimit, atëherë duhet pranuar si rezultat i doktrinës së prapë në kundërshtim me atë kur'anore, e jo se dispozitat islame janë jo të plota. Këtë prapësi e kanë shkaktuar ata të cilët i mbaj- në njerëzit larg nga mësimi islam dhe i okupojnë me shfaqjet korruptuese, siç janë filmat pornografik, publikimet amorale etj.

E drejta tjetër, të cilën Islami ia ka dhënë mashkullit, është e drejta në poligami. Tani të shohim se a është kjo ide ekstreme dhe a është në kontraditë me rendin natyror, ose paraqet përparësi për shoqëri dhe është në harmoni me natyrën. Fragmenti që pason do t'ju ndihmojë të kuptoni më mirë.

1. Mashkulli është riproduktiv që nga puberteti i hershëm dhe deri në pleqërinë e vonshme, ai është i aftë të kryejë rolin e tij riproduktiv, ndërsa femra bëhet sterile pas moshës pesëdhjetëvjeçare.

Prandaj, mashkulli njëzetvjeçar i martuar me femrën pesëmbëdhjetëvjeçare, sigurisht është riproduktiv në periudhë martesore prej tridhjetëepesë vjetësh. Pas kësaj periudhe mashkulli akoma do të jetë riproduktiv deri në moshën nëntëdhjetëvjeçare. Në anën tjetër, femra nuk do të jetë riproduktive në gjysmën e

dytë të jetës bashkësho-rtore. Në pjesën tjetër bashkëshortore nuk do të ketë arë për mbjelljen e farës së mashkullit.

2. Meshkujt në funksionin e tyre reprodaktiv nuk ballafaqohen me pengesa natyrore, qofshin ato periodike ose jo. Mirëpo, femra i është nënshtruar këtyre pengesave të cilat e pengojnë rolin e saj reprodaktiv, madje edhe në rininë e hershme, siç është për shembull menstruacioni, i cili çdo muaj zgjat nga disa ditë dhe në këtë periudhë ajo nuk është në gjendje për marrëdhënie seksuale. Mandej, gjatë kohës kur është me barrë, kur barku e ushqen fetusin si edhe disa javë pas mbetjes me barrë organet reprodiktive të femrës nuk mund të kultivojnë farë të re, e kjo ndodh shpesh në fazën e ushqimit të fëmijës me gj.

3. Është e dëmshme për femrën të ketë marrëdhënie seksuale kur barku i saj nuk është i gatshëm për të mbetur me barrë. Për këtë arsye, Islami ia ka ndaluar marrëdhëniet gjatë kohës së menstruacioneve. Kuptohet, në këto raste mashkullit nuk i lejohet t'i plotësojë nevojat e veta seksuale, ai mbase do të ketë marrëdhënie kundër rregullave, posaçë-risht meshkujt që jetojnë në viset tropike dhe ata të cilët janë plot pasion dashurie.

4. Femra prej natyrës është e aftë për martesë disa vjetë më herët se meshkujt dhe ky fakt duhet të kihet parasysh kur të caktohet moshë e ligjshme për martesë.

Prandaj, madje edhe supozojmë se të dy gjinitë janë të barabarta për nga numri (ndonëse numri i femrave zakonisht e kalon numrin e meshkujve), megjithatë duhet pranuar se gjithnjë do të ketë më tepër femra për martesë se meshkuj.

5. Pasi mashkulli i ekspozohet më shumë rreziqeve, siç janë luftërat, fatkeqësitë e të ngjashme, ka një numër të madh femrash të veja dhe vajzash të reja, të cilat janë të afta për martesë, por mbesin të pamartuara. Siç është rasti në Gjermani dhe në disa

vendeve të tjera në të cilat, ndonëse kanë kaluar shumë vite nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, pasojat e saj vërehen ende dhe zbulojnë shkakun e animit ndaj poligamisë në këto rajone. Faktet e theksuara dhe të kuptuarit që qëllimi natyror i bashkësisë martesore, ekzistimi i llojit njerëzor dhe shtimi i natalitetit të njerëzimit tregojnë qartë përse Islami mashkullit ia lejon të drejtat e poligamisë. Megjithatë, duhet theksuar se në Islam e drejta e poligamisë i nënshtrohet respektimit të përpiktë të drejtësisë ndaj bashkëshortëve. Kjo për arsye se Islami konsideron se mashkulli mund të praktikojë poligaminë me kusht që të gjithë bashkëshortët t'i trajtojë në baza të njëjta. Aq më tepër, Islami gjithashtu ka prezantuar mënyrën e cila i mundëson femrës ta kufizojë këtë të drejtë të mashkullit, si dhe të drejtën për shkurorëzim. Të gjithë e dinë se në vendet në të cilat ligji mbi poligaminë është pranuar zyrtarisht, meshkujt nuk kënaqen vetëm me një femër dhe zhyten në marrëdhënie të pa-rregullta jashtmartesore (adulteri e njëfishtë ose e dyfishtë). Në ligjëratën e mbajtur në tubimin e anëtarëve të kishave të Gjermanisë, Isak Teler, këtë fakt e ka komentuar me këto fjalë: *“Është e vërtetë se të krishterët lidhin kurorë vetëm me një femër, mirëpo e dimë edhe se ata mbajnë marrëdhënie të parregullta jashtëmartesore fshehurazi.”*

Aq më tepër, në këto bashkësi kz akt i turpshëm është fare i zakonshëm, si për shembull në Angli ku ky akt i djallit konsiderohet, sipas të gjitha gjasave, më i turpshëm se në vendet e tjera perëndimore. Reportazhet e “Kenzit”, “Lefindonit” dhe të tjerëve në lidhje me këtë tematikë dëshmojnë se si të ashtuquajturit aristokratë zhyten në këtë akt të turpshëm i cili shpesh përfundon me vetëvrasje dhe vrasje.

Më të vërtetë, është për t'u çuditur se në vendet në të cilat “martesat e egra” - (praktikimi i jetës së përbashkët të mashkullit dhe të femrës pa lidhje bashkëshortore legale) me ligj nuk janë të ndaluara, marrëdhëniet abnormale seks-uale janë në rregull. Në

anën tjetër, ajo që tmerron është fakti se përkundër kësaj çorodie të shfrenuar dhe divijacio-neve seksuale në këto vende, ata ende nuk janë pesimistë sa i përket poligamisë dhe faktorëve të përkohshëm të marte-sës, të cilët e kanë për qëllim parandalimin e përdhosjeve dhe adulterisë.

ISLAMI DHE TË DREJTAT E FEMRËS

Diskutimi mbi të drejtat e femrës dhe lirisë së saj është njëra ndër temat më aktuale dhe joshëse për të cilat është folur në disa vitet e fundit në qarqet e botës lindore. Vendet Islame, gjithashtu, janë të zëna me këtë problematikë, ndërsa shoqëritë e ndryshe kanë pikëpamje të ndryshme në lidhje me këtë temë, pozitive ose negative.

Për ko incidencë rrethanash përmbajtja shtrihet jashtë suazave të diskutimit tonë dhe ngadalë hyn në fushën e veprimit, duke shkaktuar disa fenomene të jashtëzakonshme në ambientin islam. Këta filiza të lirisë dhe të të drejtave të barabarta, për ko incidencë rrethanash, janë shtrirë aq larg, me të drejtë ose gabimisht, sa arrijnë limite sensacionale në atë masë sa që çdo gjë bëhet e rrezikshme dhe neveritëse.

Natyrisht, në këto shqyrtime, ose aktivitete, emri i Islamit është gjithashtu i përfshirë dhe janë bërë interpretime të larmishme të pikëpamjeve islame. Disa madje deklarojnë se Islami i kundërvihet plotësisht çdo lirie dhe progresi të femrës, si dhe

Islami femrën e shikon kafshatë për të vuajtur e robëruar tërësisht nga dora e mashkullit, të cilës i mohohen të gjitha të drejtat dhe privilegjet shoqëro-re. Ajo, në bazë të pikëvështrimit të tyre, nuk ka të drejtë në pronë, andaj as në dinjitet. Nuk ka të drejtë në të zgjedhjen e bashkëshortit të saj dhe nuk ka ndikim në përcaktimin e fatit personal. Asaj i janë mohuar shumë të drejta. Nga ajo kërkohet të jetë e verbër për nga sytë dhe e shurdhër për nga veshët; e mbyllur në shtëpi, e izoluar nga shoqëria, për të zbatuar me përunjësi çdo ide të bashkë-shortit të vet. Ajo është e gjykuar të jetojë jetën e një krijese të gjorë, duke mos luajtur ndonjë rol me rëndësi në shoqërinë njerëzore. Jeta e destinuar për të është kryesisht e rëndë dhe në të është e gjykuar të jetojë e vdesë pa të drejta dhe dinjitet.

Ky është vetëm një nga përsiatjet e kundërshtarëve të Islamit në lidhje me të drejtat e femrës. Disa ekstremistë mendojnë, me çdo kusht, se mund t'i komentojnë edhe ligjet islame konform paramendimeve dhe imagjinatave të tyre dhe të orientojnë ligjet e ndritura të Islamit në bazë të imagjinatës së tyre. Ata pohojnë se Islami femrës ia ka lejuar të gjitha të drejtat dhe liritë, duke i mundësuar të marrë pjesë krahas mashkullit në të gjitha sferat e shoqërisë. Nganjëherë e paraqesin si person të pranishëm në fushëbetejë, nganjëherë në pozitë të mëkëmbësit dhe ministrit. Ajo mund të përvjelë mënget dhe të punojë në lëshimin e raketave, mund të komandojë dhe të nënshkruajë kontrata paqësore.

Prej saj, kohë pas kohe, kërkohet të vallëzojë me meshkuj dhe të gërshetojë duart me duart e çdo miku, çdo të huaji, ose madje të paraqitet në bikini në lokalet ose plazhet publike. Këta njerëz nuk gjykojnë me arsye lidhur me rolin shoqëror të femrës, saqë që formalisht mohojnë edhe doktrinat islame.

Për këtë arsye ata synojnë, aq sa kanë aftësi, të sqarojnë dhe interpretojnë edhe ligjet islame për të arritur qëllimet e tyre.

Ekziston edhe një grup i cili, pa kurrëfarë rezerve dhe ngurrimi, haptas dhe në mënyrë të qartë synon drejt qëllimeve të veta personale. Atyre aspak nuk u intereson se shteti është islamik dhe sa banorët e tij janë pjesëtarë të doktrinës islame. Ata shkojnë më tutje drejt trillimeve, imagjinatave dhe imitimeve të pakuptimta të tjerëve.

Pasojnë përgjigjet e pyetjeve se si, se si ka filluar ky shqyrtim dhe cila është origjina e tij.

NDRYSHIMET E POZITËS LIGJORE TË FEMRËS NË EVROPË

Në shoqërinë barbare femra është konsideruar si qenie e ulët njerëzore ose si pronë e tundshme. Ajo është përdorur për të kënaqur nevojat lapërdhare, ka qenë e detyruar të jetë shërbëtoresh dhe të kryejë punë të thjeshta. Ajo ka qenë argat e në pranga që jeton për të qenë e eksploatuar nga mashkulli në çdo mënyrë që i konvenon atij. Ajo nuk ka jetuar për të gëzuar jetën ose për t'i

praktikuar të drejtat dhe privilegjet njerëzore.

Më vonë, në shoqëritë gjysmëbarbare dhe gjysmë të civilizuar njerëzore, femra ende ka qenë objekt shqyrtimesh dhe janë shprehur shumë mendime të ndryshme në lidhje me të, për shembull:

- Femra është krijim i fëlliqur i djallit, ajo nuk ka shpirt njeriu, prandaj as jetë në botën tjetër - ajo është vegël e mashtrimit të Satanit, andaj duhet të torturohet fizikisht; - vdekja, helmi, zjarri dhe gjarpërinjtë janë më pak të lig në krahasim me femrën - vajzat duhen futur të gjalla në dhe në mënyrë që të pastrohen vrragët e trupit të tyre - femra është qenie njerëzore e krijuar për t'i shërbyer mashkullit.

Këto dhe teza të ngjashme lidhur me pozitën e femrës i kanë mbrojtur romakët, arabët, francezët dhe athinasit e lash-të.

Shoqëritë e civilizuar evropiane femrën e konsiderojnë qenie njerëzore, mirëpo ia mohojnë shumë të drejta njerëzore. Nuk e kanë pranuar as si qytetare të shtetit, as nuk ia kanë dhënë kurrfarë të drejtë personale. Nga vajzat e reja është kërkuar të pranojë për burrë atë që ia kanë zgjedhur prindërit. Femra ka qenë vetëm objekt për kënaqjen e dëshirave lapërdhare të meshkujve dhe është mbajtur vetëm për këtë qëllim. Ajo është përdorur si fuqi punëtore në ferma dhe në shtëpi, përveç kësaj, ajo nuk ka gëzuar kurrfarë mbrojtje ligjore.

Pas arritjes së revolucionit industrial, familjet evropiane kanë bërë jetë modeste dhe të matur, femra ka marrë pjesë në punët e

bujqësisë dhe të shtëpisë. Kryesisht janë marrë me zeje të vogla në kuadër të punëve të shtëpisë. Jeta familjare e femrës pranë fëmijëve të burrit ka qenë e kufizuar në shtëpi dhe në punë amvisërie, por e pasuruar me ambiente të dashurisë dhe kujdesit të ndërsjelltë. Kurse për numër të madh punëtorësh rezultoi me rrënimin e familjes. Femrat dhe fëmijët ishin të detyruar të braktisin ngrohtësinë e atmosferës familjare në fshatrat e tyre dhe të shkojnë në qytete dhe vendbanime industriale. Kushtet e vështira dhe rraskapitëse të punës, rrënimet e familjeve, ngatërrimi ilegal i femrave dhe meshkujve në vendet e tyre të punës, presioni i vrullëve seksuale nga të dyja anët, erozioni i ndjenjave familjare, eksploatimi i femrës së pambrojtur nga ana e manaxherëve industrialë me qëllim të kënaqjes së pasio-neve të tyre dhe përhapja e korrupsionit përgatitën terrenin e përshtatshëm për revolucion. Barra e jetës ra tërësisht mbi supet e femrës, asaj iu mohon shumë të drejta dhe privilegje të jetës së qetë familjare. Ato humbën burrat, fëmijët, nderin, pastërtinë morale dhe çdo gjë tjetër. Lufta gëlltiti miliona meshkuj. Pronarët e fabrikave kishin nevojë të madhe për femra si fuqi punëtore për t'i mbajtur në lëvizje rrotat e industrisë, megjithatë kurrë nuk e vlerësuan si duhet kontributin e tyre dhe vazhduan t'i eksploatojnë ato. Madje nuk u jepnin as meditet meritore. Diskriminimi i femrës vazhdoi. Ato u ngatërruan në të gjitha llojet e korrupsionit dhe ndotjes morale. Femra e pambrojtur u thye nga presionet e vazhdueshme dhe u detyrua t'i nënshtrohet kësaj jete të imponuar të poshtërimit dhe ekzistencës çnjerëzore. E

kishin të qartë se kishin humbur çdo gjë: ishin të detyruara t'i lëviznin rrotat e industrisë, të mbanin mbi vete tërë barrën dhe akoma ta mbajnë gojën të mbyllur. Ishin të detyruara të tolerojnë shtypjen, por të mos protestojnë.

Natyrisht, punonin krah për krah me mashku-llin, mirëpo në realitet ato nuk ishin asgjë më tepër se krije-sa të shtypura që mbanin barrë, të robëruara në duart e një grushti përfituesish. Në çdo çast duhet t'i jepeshin secilit që i tekej, duke përjetuar fyerje të ndryshme për paga mizore.

Presioni dhe marrëdhëniet çnjerëzore nxitën ndjenjat e tyre dhe i trimëruan ato të ngrihen në protesta dhe greva, të cilat rezultuan me burgosje dhe vrasje. Rezultat i aktiviteteve të vazhdueshme ishte rruga drejt qendrave të pushtetit dhe trupave legjislativ. Ngadalë dhe gradualisht, jo vetëm që ia arritën qëllimit për paga të barabarta me meshkujt, në punën e njëjtë që bënin me ta, por edhe realizuan të drejta të barabarta me meshkujt, me të drejtën për pjesëmarrje në të gjitha sferat e aktiviteteve. Është çështje për diskutim në ç'masë janë të mirëseardhura këto liri dhe barazi për mashkullin dhe femrën, respektivisht, sa janë të dobishme për ta? Kjo është temë për një shqyrtim tjetër për të cilin do të diskutohet një rast tjetër.

ARDHJA E FEMRËS SË LIRË NË VENDET E LINDJES

Evropa me progresin e saj industrial e ka realizuar hegjemoninë industriale mbi tërë botën. Kjo është përcjellë me aktivitetet e gjera edhe në fushat e tjera. Civilizimi evropian, me pompë dhe trumbetime, ia doli të grabisë rolin udhëheqës në botë dhe të tërheqë vëmendjen e popujve të pa- zhvilluar ekonomikisht.

Të ngatërruar me dobësinë morale dhe shpirtërore, këta adhurues të Perëndimit kthenin shikimin në drejtim të tij duke pritur me zjarr që t'i shprehin mirëseardhje çdo gjëje që vjen nga Evropa.

Zhurma mbi lirinë e femrës dhe degëzimet e saj praktike gjetën rrugën deri te vendet islame, ku i pritën me mirëseardhje të përzemërt, si margaritarë nga Perëndimi, duke harruar se ato janë krijime të rrethanave specifike dhe zhvillimit të posaçëm në Perëndim, që ka kërkuar një përfundim të tillë; meqënëse këto kondita nuk kanë dominuar në vendet islame. Gjatë shekujve të kaluar, Islami femrës ia ka caktuar identitetin e denjë duke ia dhuruar të gjitha të drejtat dhe privilegjet njerëzore, duke përfshirë këtu edhe disa të drejta të posaçme në sfera të veçanta. Do të shqyrtohet në mënyrë të hollësishme, në ç'mënyrë Islami për gjininë femërore një pozitë të privilegjuar siguroi dhe si ia caktoi këtë pozitë të denjë në harmoni me konstitucionin fizik dhe intelektual të saj.

RAPORTI MIDIS STRUKTURËS NATYRORE TË FEMRËS DHE TË DREJTAVE TË SAJ

Meqë në këtë pjesë po hapim tematikën kryesore, duhet të shqyrtojmë çështjen e të drejtave të femrës nga pikëpamja islame duke i lënë anash të gjithë fanatizmat, duke qëndruar larg nga presionet e rrethit dhe nga konfuzioni i egër i ithtarëve të “civilizimit”. Por, para së gjithash, shkurtimisht do të shqyrtojmë pozitën e mashkullit dhe të femrës nga pikëpamja e strukturës fizike, aspektit biologjik dhe psikologjik dhe të shikohet se a kanë këto dy krijesa ngjashmëri në këtë aspekt apo jo. Nëse kanë, a kërkojnë këto ndryshime që çdonjëri prej tyre (mashkulli dhe femra) të ketë kufizime apo të drejta të posaçme? Gjithashtu, shtrohet pyetja, a janë këto dallime në këso konditash, të posaçme, të papajftueshme apo kontradiktore me identitetin njerëzor dhe pozitën sociale të çdonjërit prej tyre?

Bota është përplot me gjëra dhe fenomene të ndryshme, ku çdonjëra posedon veçoritë e veta, të cilat e dallojnë nga të tjerat. Çdonjëra ka kufizimet e saj individu-ale dhe pamjen e veçantë, që i sjelli asaj elegancë dhe fisnikëri. Ekzistojnë dallime në mes të shtazëve, faunës dhe florës, dhe ngjashmëri midis individëve të llojit të njëjtë. Ngjashëm me këtë, qeniet njerëzore ndryshojnë dhe zotëro-jnë karakteristika individuale. Dallimet midis të llojeve janë të thella, kurse midis individëve janë sipërfaqësore. Sido-qoftë, dy persona nuk janë të njëjtë në çdo pikëpamje, saqë edhe shenjat e gishtave të dy personave janë të mjaftue-shme për të dalluar njërin nga tjetri, e të mos i përmendim të tjerat. Janë

evidente dallimet midis njerëzve në botë-kuptimet e tyre (të menduarit, afinitetet, ndjenjat, aftësitë mentale dhe fizike, intensiteti i instiktit, pamja e jashtme, lartësia dhe pesha, si dhe faktorët e tjerë të brendshëm dhe të jashtëm). Efekti i këtyre dallimeve sipërfaqësore është dëshmuar me pozitën dhe vendin që këta individë e kanë arritur në shoqëri. Çdonjëri, në harmoni me aktivitetin e tij, e mbart një hisë të barrës shoqërore. Kjo është ajo ndryshueshmëri e cila përmbush të gjitha kërkesat e shoqërisë dhe amshon zhvillimin e jetës.

Sa u përket meshkujve dhe femrave, ekzistojnë disa ndryshime më të thella dhe më të rëndësishme, që dallojnë këto dy gjini dhe përcaktojnë detyrat dhe pozitat e posaçme për çdonjërin prej tyre. Në atë masë sa merr pjesë struktura fiziologjike, mashkulli zakonisht është i pajisur me nerva të forta, strukturë më të shprehur fizike, peshë dhe lartësi më të madhe. Kjo vetvetiu flet se ai është i krijuar për detyra më të rënda dhe më të komplikuar. Pjesa e trurit, që drejton emocionet është më e madhe te femrat, ndërsa pjesa e trurit, e destinuar për persiatje dhe gjykim është më e madhe te meshkujt. Përkundër kësaj, është evidente se truri i femrës është i pajisur me organe për rritje dhe ushqim të femijës me qumësht. Kjo veti specifike e nevojshme për femrën tregon se rritja e fëmijëve është detyrë e saj. Rritja e fëmijës kërkon fuqi dhe begati ndjenjash të domosdoshme për zhvillimin normal të tij.

Pa dyshim, femra me veçoritë e saj specifike fizike është e destinuar të rrisë fëmijët, për këtë arsye natyra e ka pajisur me

emocione të nevojshme dhe ndjenja të fuqishme dashurie dhe disponimi ndaj fëmijës. Kjo mban disiplinë dhe rend në jetën e njeriut. Është fakt i rëndësishëm se femra në krahasim me mashkullin është e pajisur me dashuri më të madhe dhe sentimente më të buta; kjo dëshmon përgjegjësinë e saj specifike ndaj shoqërisë njerëzore. Kur të kihet parasysh kjo nuk ka nevojë për kurrfarë argumentesh të elaboruara.

ROLI I TË MENDIMEVE DHE I EMOCIONEVE

Dashuria është ndjenjë e thellë subtile, e cila formon prirje për tolerancë, trimëri dhe durim. Ajo gufon shpejt dhe ka efekte të thella dhe direkte. Ajo është ndjenjë e cila nuk varet nga gjykimi ose nga ndonjë ngurrim paraprak. Ajo qëllimin e saj e arrin shpejt, andaj planifikimi i kujdesshëm për një kohë të gjatë është i panevojshëm. Me fjalë të tjera, dashuria është interes i thellë dhe pasion i fuqishëm, sipërfaqësore dhe nuk ka rrënjë të thella, por njëkohësisht është elegante dhe mrekulluese. Vaji ose të qeshurit e fëmijës lartëson zemrën e nënës dhe ndez dashurinë e saj të thellë. Me dashuri të zjarrtë amnore kënaqen nevojat e vazhdueshme të fëmijës. Gjëma dhe psherëtima e dhimbshme e pacientit, si dhe figura e tij e dobësuar, mund të bëjë përshtypje vetëm në zemrën e ndieshme, e cila do të kujdeset për të me përkujdesje të palodhshme medicinale.

Tablloja e synimeve të palodhshme dhe të vazhdueshme të mashkullit në luftën për jetesë, balli i tij i djersitur, fytyra e tij e

lodhur me nerva të rraskapitura zgjojnë te femra ndjenjën e dhembshmërisë. Kjo ndjenjë nxit përpje-kjet e saj që shtëpia të jetë vendpushim i këndshëm dhe plot lumturi, në mënyrë që rraskapitja e bashkëshortit, e shkaktuar nga lufta e tij për ekzistencë, të kompensohet me atmosferën familjare të mbushur me dashuri dhe ngrohtësi. Rezultat i kësaj dhembshmërie dhe freskie sentimentale plot dashuri është se mashkulli harron rraskapitjen e tij.

Kjo është shija delikate e femrës dhe ndjenja e saj për elegancë, e cila e fisnikëron bashkëshortin e saj dhe fëmijët, i jep pamje plot sharm dhe shkëlqim shtëpisë dhe atyre u jep zjarr dhe vullnet për jetë.

Përkundër kësaj, sigurimi i bukës dhe lufta për jetë kërkojnë largpamësi dhe durim, kurse këto të dyja kërkojnë konsideratë. Sentimenti nuk mund të tolerojë që të shikojë caqet nga një largësi e madhe, nuk mund të mbëltojë në zemër dashurinë që ndoshta do të piqet dhe frytet e saj do të vilen pas dhjetë vitesh, që ndoshta edhe do të lajmërohe-shin si përrallë ose mit, për realizimin e të cilave duhet të tolerohen të gjitha llojet e vuajtjeve. Nuk mund të kalojë këtë distancë të gjatë, të tejkalojë pengesat dhe të hapë shtegun drejt suksesit. Shpirti i ndieshëm nuk përshtatet mirë me manifestimet mashtruese dhe të larmishme në rrugën e kërkimit të ekzistencës. Kjo rrugë e vështirë kërkon fuqi që i kundërvihet sentimenteve delikate dhe është e përcjellë me qëndrueshmëri të zjarrtë, që nuk dorëzohet lehtë porse tregon tolerancë dhe gjakftohtësi që i pranon sentimentet dhe emocionet. Nëpër një

këmbëngulje dhe tolerancë të tillë mashkulli duhet të ketë vrapin e arritjes së progresit dhe realizimit të qëllimeve të veta.

Prej mashkullit varet përkrahja dhe siguria e familjes së tij, pa marrë parasysh a e realizon këtë duke prerë dru në mal ose duke drejtuar makina të mëdha industriale dhe instalime, me pjesëmarrje në fushëbetejë ose me udhëheqje në pushtet dhe shoqëri. Gjithçka kërkon punë të munda-mshme, largëpamësi dhe planifikim. Kjo nuk mund të arrihet me sentimente delikate, me shpirt emocional, ose me zemër të butë. Çdo organizatë posedon interesat karakteristike vetanake. Administrimi i aspekteve të ndryshme të jetës, kërkon kualitete të ndryshme, nganjëherë providencë, e nganjëherë mëshirë, nganjëherë subtilitet dhe ndjenja, kur-se nganjëherë fuqi dhe qetësi.

TË DREJTAT E BARABARTA TË MASHKULLIT DHE FEMRËS NGA PIKËPAMJA ISLAME

Islami mashkullin dhe femrën i konsideron të barabartë për sa kjo ka të bëjë me të drejtat elementare njerëzore. Jo vetëm që i pranon tiparet individuale të atij dhe asaj, por, gjithashtu, i konsideron të barabartë në të gjitha të drejtat dhe privilegjet njerëzore. Ajetet kur'anore e vërtetojnë këtë qëndrim:

“O njerëz, Ne ju krijuam prej një mashkulli dhe një femre dhe ju ndajmë në popuj e fise që të njiheni. Më i devotsbëm tek Allahu është ai i cili atij i frikësohet më së shumti...” (49:13)

“Asnjërit prej jush që mundohet, mundin e Tij nuk do t'ia mohojnë, as mashkullit as femrës, ju jeni njëri prej tjetrit...” (3:195)

“Kurse besimtarët dhe besimtare të janë të dasbur për njëri-tjetrin: kërkojnë të kryejnë vepra të mira, kurse largohen nga ato të pahijshmët, dhe falin namazin dhe japin zekatin, dhe respektojnë Allahun e Pejgamberin e Tij. Ata janë prej atyre për të cilët Allahu do të ketë mëshirë...” (9:71)

“Muslimanëve dhe muslimaneve, edhe besimtarëve dhe besimtareve, edhe meshkujve të bindur dhe femrave të bindura, edhe meshkujve të singertë dhe femrave të singerta, edhe meshkujve të durueshëm dhe femrave të durueshme, edhe meshkujve të përvuajtur dhe femrave të përveu-ajtura, edhe meshkujve të cilëve japin zekat dhe femrave të cilat japin zekat, edhe meshkujve të cilët agjerojnë dhe femrave të cilat agjerojnë, edhe meshkujve të cilët kujdesen për vendet e turpshme dhe femrave të cilat kujdesën për vendet e turpshme, edhe meshkujve të cilët e përmendin shumë Allahun dhe femrave të cilat e përmendin shumë Allahun. Allahu, me të vërtetë, për të gjithë ata ka përgatitur shpërblim të madh.” (33:35)

“O besimtarë, meshkujt mos të tallen me njëri-tjetrin, ngase ata mund të jenë më të mirë se ata, por as femrat me femrat e tjera, ngase mund të jenë më të mira se ato. Dhe mos qortoni njëri-tjetrin dhe mos e quani njëri-tjetrin me ofiqe të shëmtuara...” (49:11)

“Ne njeriut i kemi urdhëruar t'i respektojë prindërit e vet. Nëna e bart atë, shëndeti i saj pëson dhe e largon (nga gjiri) pas dy viteve. Bëhu mirenjohës i Imi dhe i prindërve të tu...” (31:14)

“Ata janë veshja juaj, kurse ju jeni veshja e tyre...” (2:187)

“Meshkujve u takon hise një pjesë nga ajo që e lëjnë prindërit dhe të afërmit, por edhe femrave një pjesë që e lëjnë prindërit dhe të afërmit...” (4:7)

“Meshkujve u përket shpërblimi për atë që e bëjnë ata, kurse femrave u përket shpërblimi për atë që e bëjnë ato...” (4:32)

“Lapërdharin dhe lapërdharen fshkullojuni me njëqind goditje të kamxhikut, çdonjërin prej tyre, dhe të mos u kaplojë kurrfarë keqardhjeje ndaj tyre gjatë zbatimit të dispozitës së Allahut, nëse besoni në Allahun dhe në botën tjetër...” (24:2)

“Thuaju besimtarëve të ulin shikimin e tyre dhe të kujdesen për vendet e turpshme të trupit të tyre: kjo është më mirë...”; “Kurse thuaju besimtarëve të lëshojnë shikimet e tyre dhe të kujdesen për vendet e turpshme të tyre...” (Kur'an, 24:30 - 31)

“Vjedhësit dhe vjedhëses prejani duart, kjo le të jetë dënimi për ata që e kanë bërë dhe vërejtje nga Allahu...” (Kur'an, 5:38)

Këto ajete janë vetëm shembuj, ekzistojnë shumë ajete të cilat flasin qartë edhe për mashkullin edhe për femrën, dhe të cilat me shprehjet “O njerëz” ose “O besimtarë”, u drejtohen edhe meshkujve edhe femrave. Ajetet e lartëshënuara kryesisht kanë këtë porosi: Edhe mashkulli edhe femra janë besimtarë të sinqertë dhe të përkushtuar. Shpërblimi më i mirë, xheneti dhe mëshira e Zotit, është për të dy. Të dy duhet t'i kryejnë detyrat e njëjta, për shembull: namazi, agjërimi, zekati, të përpiqen për mirë dhe të luftojnë kundër të ligës. Kriteri i përparësive të tyre individual është i bazuar në përkushtimin edhe në ruajtjen e tyre nga mëkati.

Virtytet morale, siç janë toleranca, bujaria, sinqeriteti, ndihma e të varfërve etj., janë të favorshme për të dy gjinitë. Të dyve u është urdhëruar të kujdesen për paster-tinë dhe t'i ulin shikimet e tyre. Korrupsionet morale, siç janë: aktet e lapërdharrisë, shpifjet dhe talljet, nuk janë të dëshirueshme për asnjërin prej tyre. Të dy kanë të drejtë për trashëgim.

E drejta për pronë dhe për shfrytëzimin e saj i është dhënë edhe mashkullit edhe femrës. Babai dhe nëna meritojnë respekt shumë të madh. Mashkulli dhe femra janë përgjegjës për veprat e tyre, të cilat nuk do të mbesin të pavlerësuara. Të dy janë të barabartë para ligjit dhe dënohen për pra- pësitë e kryera. Së fundi, nëse femra është e dëmtuar në ndonjë rast nga pikëpamja e ligjit, në një rast tjetër ligji e kompenson këtë humbje dhe bën balancimin ligjor në favor të saj.

Ajetet e tjera të Kur'anit bëjnë fjalë pavarësisht për të drejtat e femrës, duke i urdhëruar njëkohësisht mashkullit t'i respektojë këto të drejta. Kur'ani e kritikon sundimin e kohës paraislame dhe raportin ndaj femrës në atë periudhë. Për shembull, ajeti e gjykon praktikën e vrasjes së fëmijëve, të gjinisë femrore me këto fjalë:

“Dhe kur vajza e varrosur për së gjalli të pyetet se për çfarë mëkati është mbytur...” (81:8 - 9)

Kur'ani diskuton për femrat e famshme nga historia e fesë dhe përshkruan jetën e tyre në suaza të qëllimit të tij. Femra të tilla janë dymbëdhjetë. Madje edhe një sure e Kur'anit quhet sura En-Nisa (Femrat), që e madhëron femrën. Në pasuset e lartshënuara

është përmendur shqyrtimi gjithëpërfshirës në lidhje me respektin që shfaqë Kur'ani ndaj femrës. Janë përshkruar gjithashtu edhe të drejtat e barabarta të mashkullit dhe të femrës. Kjo ofron bazë për shqyrtimet që do të pasojnë.

SHËNIM:

Filozofët kanë vërtetuar se struktura e trupit të mashkullit ndryshon nga struktura e trupit të femrës në të gjitha aspektet; qofshin muskujt, gjaku, eshtrat, zemra ose truri. Truri i mashkullit peshonë 100 gr. më shumë se ai i femrës, kurse mushkëritë e mashkullit janë 300 gr. më të rënda. Pesha mesatare e mashkullit është 4000 gr. më e madhe se pesha mesatare e trupit të femrës. Eshtrat e mashkullit janë më të rënda dhe më të forta. Muskujt e femrës janë më të dobët dhe më të butë. Zemra e mashkullit të zakonshëm është rreth 50 gr. më e rëndë se zemra e femrës së zako-nshme. Prandaj, ndryshimet në konstitucionin fizik reflekto-hen në aftësitë mentale të dy gjinive.

FEMRA NË ISLAM KUNDRUALL TRADITËS HEBREJE DHE KRISHTERE - MITI DHE REALITETI

Para disa vjetësh, pata lexuar në gazetën “Toronto Star” 3 Korrik 1990, një artikull të titulluar

“Islami nuk është i vetmi me doktrina patriarkale”, të cilin e kishte shkruar Gwynne Dyer.

Artikulli i përshkruante reaksionet tërbuara të pjesëmarrësve të konferencës *mbi femrën dhe pushtetin*, të mbajtur në Montreal, ndaj komenteve të feministes së shquar egiptase, doktoreshës Naval Saadavi. Deklaratat e saj të pasakta politike përfshinin edhe këtë: *“Elementet që më së shumti i pengojnë femrat mund të gjenden së pari në Judaizëm dhe Dhiatën e Vjetër, pastaj në Krishterizëm dhe në fund në Kur'an”; “të gjitha besimet janë patriarkale, pasi që rrjedhin nga shoqëritë patriarkale”; prandaj “të mbuluarit e femrës nuk është ekskluzivisht zakon islam, por traditë e lashtë kulturore, analoge me atë në religjionet simotra.”*

Pjesëmarrësit nuk mund të rrinin të qetë dhe të duronin barazimin e religjioneve të tyre me Islamin. Për këtë arsye, doktoresha Saadavi pësoi një rrebesh kritikash. *“Komentet e doktoreshës Saadavi janë të papranueshme. Përgjigjet e saj paraqesin të meta në të kuptuarit e religjioneve të tjera”,* deklaroi Bernice Dubois, nga Lëvizja Botërore e Nënave. *“Më duhet të protestoj”,* u deklaroi përfaqësuesve të tribunës Alice Shalvi, nga televizioni izraelit, *“koncepti i mbulimit në Judaizëm nuk ekziston.”* Artikulli këto protesta të mllëfosura ia përshkruan tendencës së fuqishme në Perëndim që të hidhet gurë e drunj mbi Islamin, për shkak të zakonit i cili, në realitet, është pjesë e traditës kulturore perëndimore. *“Feministet e krishtera dhe hebreje nuk dëshironin të lejojnë që mbi to të diskutohet në një kategori të njëjtë si për muslimanet e ndyra”,* shkruante Gwenne Dyer.

Nuk më befaso! Fakti që pjesëmarrëset e konferencës kishin një pikëpamje të tillë negative mbi Islamin, posaçërisht kur kemi të bëjmë me femrat. Islami në Perëndim është konsideruar si simbol *par excellence* i nënshtrimit të femrës. Për ta kuptuar sa është e fortë kjo bindje, mjafton të përmendet që Ministria e Arsimit në Francë, në atdheun e Volterit, para pak kohësh ka urdhëruar që nga shkollat fren-ge të përjashtohen të gjitha muslimanet e reja të cilat do të mbajnë shami!

Ajo që më kishte intriguar më së shumti në lidhje me këtë konferencë ishte pyetja: Sa ishin të bazuara në fakte deklaratat e doktoreshës Saadavi ose kritikrat e saj?

Me fjalë të tjera, a e kanë Judaizmi, Krishtërizmi dhe Islami një koncept të njëjtë në lidhje me femrat? Apo kanë koncepte të ndryshme? A i ofrojnë Judaizmi dhe Krishtërizmi njëmend femrës pozitë më të mirë se Islami? Cila është e vërteta?

Nuk është lehtë të kërkohet dhe të gjenden përgjigjet për këto pyetje të vështira. Vështirësia e parë është se duhet të jesh i drejtë dhe objektiv ose, në rastin më të thjeshtë, bëjmë gjithçka që të jemi të tillë. Kjo është ajo çka predikon Islami. Kur'ani na urdhëron ta themi të vërtetën, madje edhe nëse ajo nuk i pëlqen të afërmëve tanë:

“Dhe kur të flitni, duhet të jeni të drejtë, madje edhe nëse ka të bëjë me të afërmit tuaj.” (6:152)

“O besimtarë, dëshmoni gjithnjë drejt, për hir të Allahut, madje edhe nëse është në dëm të tuaj ose në dëm të prindërve tuaj dhe të afërmëve, qoftë ai i

pasur apo i varfër.” (4:135)

Vështirësi tjetër e madhe është edhe gjerësia shumë e madhe e temës. Për këtë arsye, vitet e fundit kam kaluar shumë çaste duke lexuar Biblën, Enciklopedinë e Religjionit, si dhe Enciklopedinë e Judaizmit duke kërkuar përgjigje. Gjithashtu, kam lexuar disa libra që bëjnë fjalë mbi pozitën e femrës në religjione të ndryshme, të shkruara nga mendimtarë, apologjetë dhe kritikë.

Sot dëshiroj t'ua prezantoj disa zbulime të rëndësishme të këtij hulumtimi modest. Nuk dua të pretendoj se jam absolutisht objektiv. Kjo është tepër për fuqinë time të kufizuar. Krejt çka mund të them është se jam përpjekur që përmes këtij hulumtimi t'i ofrohem idealit kur'anor për thënien e së vërtetës.

Para se të filloj, dëshiroj të theksoj se qëllimi i kësaj trajtëse nuk është diskreditimi i Judaizmit ose i Krishte-rizmit. Si muslimanë, ne besojmë në prejardhjen hyjnore të këtyre dy besimeve. Askush nuk mund të jetë musliman, nëse nuk beson në Musain dhe Isain si Pejgamberë të shquar të Allahut. Qëllimi im i vetëm është që të mbroj Islamin dhe të shpreh respektin e merituar për shpalljen e fundit të Zotit gjinisë njerëzore.

Gjithashtu, dëshiroj të theksoj se jam marrë me doktrina. Kjo do të thotë se jam interesuar kryesisht me pozitën e femrës në këto tri religjione, ashtu siç mësohet në burimet origjinale, e jo ashtu siç e praktikojnë miliona njerëz në botën bashkëkohore. Prandaj, shumica e argumenteve që do të paraqiten janë nga Kur'ani, Bibla, Talmudi dhe mësimet e disa krerëve më të shquar

kishtarë, pikëpamjet e të cilëve kanë kontribuar shumë në definimin dhe formësimin e Krishterizmit. Ky interesim për burimet rrjedh nga fakti se botëkuptimi i një religjioni të caktuar dhe qëndrimeve e sjelljeve të ithtarëve të tyre nominalë gjithnjë largon nga e vërteta. Shumë njerëz e ngatërrojnë kulturën dhe religjionin, shumë prej tyre madje nuk dinë asgjë në lidhje me atë se ç'thonë librat e tyre fetare, kurse shumë të tjerëve as që u intereson kjo gjë.

GABIMI I EVËS (HAVËS)

Të tri religjionet pajtohen në një fakt themelor: edhe femrat edhe meshkujt i ka krijuar Zoti, Krijuesi i tërë gjithësisë. Megjithatë, dallimi fillon menjëherë pas krijimit të njeriut të parë, Adamit (Ademit) dhe femrës së parë, Evës (Havës). Pikëpamjet hebrejo - krishtere të krijimit të Adamit dhe Evës janë përshkruar detajisht në librin e Prejardhjes, 2:4 - 3:24. Zoti atyre u kishte ndaluar të hanin fruta nga druri i ndaluar. Gjarpëri e mashtron Evën që të hajë prej tij, kurse Eva si revanshim e mashtrimit Adamin që të hajë me të. Kur Zoti e qortoi Adamin për atë që kishte bërë, ai ia hodhi fajin Evës. *“Gruaja, të cilën e ke vendosur këtu pranë meje, më dha pakë frut nga pema dhe unë e hëngrë.”* Si rezultat, Zoti i thotë Evës: *“Unë do t'i shtoj shumë dhimbjet e tua gjatë lindjes, me dhimbje do t'i sjellësh fëmijët në jetë. Ti do ta duash burrin tënd, kurse ai do të sundojë mbi ty.”* Ndërkaq Adamit i thotë: *“Për arsye se e ke dëgjuar gruan tënde dhe kë ngrënë nga pema...qoftë mallkuar toka për shkak tëndin,*

me punë të rëndë do të hash prej saj tërë kohën e jetës tënde...”

Mësimi islam i krijimit të parë mund të haset në disa vende në Kur'an:

“Kurse ti, o Adem, edhe gruaja e jote, në xhenet do të jetoni dhe hani prej nga të doni, vetëm kësaj peme mos iu afrohuni, që mos të bëni mëkat ndaj vetvetes! Dhe shejtani filloi t'i hamagjisë... - Zoti juaj ju ndalon këtë dru vetëm që të mos bëheni melekë ose të mos bëheni të pavdekshëm. Dhe u betohej; “Unë jam, me të vërtetë, këshilltar i singërtë! E kur ata këtë pemë e shijuan, vendet e tyre të trupit u shfaqën.” A nuk ua kam ndaluar të hani nga kjo pemë?!” u thirri Zoti i tyre... Ata deklaruan; “O Zoti ynë, vetë jemi fajtorë dhe nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, me siguri do të jemi të humbur.” (7:19 - 25)

Analizimi i kujdesshëm i këtyre dy fragmenteve të rrëfimit mbi krijimin zbulon disa dallime të rëndësishme. Kur'ani, për dallim nga Bibla, e fajëson Ademin dhe Havën njësoj për fajin e tyre. Askund në Kur'an nuk mund të gjendet as aluzioni më i vogël që Eva e ka nxitur Ademin të hajë nga pema e ndaluar, as që ka ngrënë para tij; Hava në Kur'an nuk është burim i sprovës, nuk ka mashtruar dhe nuk ka tradhtuar. Aq më tepër, Eva nuk mund të fajësohet për dhembjen e lindjes. Zoti, në bazë të Kur'anit, nuk e ndëshkon asnjërin për mëkatet e tjetrit. Edhe Ademi edhe Eva kanë bërë mëkat dhe pas kësaj janë penduar para Zotit, andaj Ai ua fali mëkatin.

TRASHËGIMIA I EVËS

Tabloja e Evës, si sprovë në Bibël, ka rezultuar me një qëndrim tejet negativ ndaj femrës në traditën hebrejo-krishtere. Për ta kuptuar se çfarë ndikim negativ ishte ne duhet të shikojmë ç'kanë shkruar disa nga hebrejntë dhe krishterët më të shquar të të gjitha kohëve.

Të fillojmë me Dhjatën e Vjetër dhe të dëgjojmë një fragment nga libri Predikuesi, në të cilin hasim:

“Supozoj se më e hidhur se vdekja është gruaja, e cila është kurth, zemra e të cilës është pusi dhe duart e së cilës janë zinxhirë. Njeriu i cili i nënshtrohet Zotit, do të largohet nga ajo, ndërsa me katarin ajo do ta kap në kurthin e saj... gjersa vetë kërkoja e nuk gjeja dot, e hasa një njeri të ndershëm, në mesin e një mijë të tjerëve, e nuk kam hasur asnjë grua të ndershme në mesin e të gjithave.” (7:26 - 28)

Njeriu duhet të pyesë se çfarë urtie mund të ketë në mohimin e madje vetëm një femreje të ndershme në tokë? Në një pjesë tjetër të literaturës hebreje, që gjendet në Biblën Katolike, lexojmë: *“Asnjë ligësi nuk mund as t'i ofrohet ligësisë së femrës... Mëkati ka filluar me femrën dhe falë asaj të gjithë dubet të vdesin.” (Sirah, 25:19 - 24)*

Hebrejntë ortodoks, gjatë lutjes së mëngjesit, deklarojnë: *“Qoftë lavduar Zotit, Mbretit i gjithësisë, që nuk më ka bërë femër.”* Nga ana tjetër, femrat çdo mëngjes i falënde-rohen Zotit me fjalë: *“...që më ke krijuar sipas vullnetit Tënd.”*

Po ky ton i rreptë mund të haset edhe në Dhjatën e Re. Dëgjoni fjalët e Shën Palit: *“Në kohën e mësimit gruaja le të dëgjojë në heshtje dhe me nënshttrim të plotë. Nuk lejoj që gruaja të mësojë*

në kishë as ta sundojë burrin, por - të rrijë në qetësi. Sepse i pari u krijua Adami, e pastaj Eva. Dhe nuk qe gënjyer Adami, por gruaja e gënjyer e theu urdhrin. Dhe do të shëlbohet duke lindur fëmijë.” (Letra e Parë, Timoteut, 2:11 - 15)

Tertuliani ka qenë edhe më i ndjeshëm se shën Pali kur bënte fjalë mbi “motrat e dashura” në fe kur deklaroi: “A nuk e dini se jeni Eva, çdonjëra prej jush? Ndëshkimi i Zotit në gjininë e juaj jeton në këtë kohë, fajti duhet të ekzistojë gjithashtu. Ju jeni porta e djallit, ju e keni prekur pemën e ndaluar, ju të parat e keni prishur ligjin e Zotit, ju jeni ajo që e keni mashtruar atë që as djalli nuk ka pasur aq guxim që ta sulmojë. Ju në mënyrë tejet të lehtë e keni mashtruar njeriun, i cili është krijuar në pamjen e Zotit.”

Shën Augustini ka qenë besnik ndaj trashëgimisë së paraardhësve të tij. Një miku i kishte shkruar: “Nuk ka dallim nëse bëhet fjalë për nënë ose bashkëshorte, ajo edhe më tej është Eva e cila mashtron, nga e cila ne duhet të kemi kujdes, tek çdo femër.”

Shumë kohë më vonë, Shën Toma Akuini supozonte se femrat janë me të meta. “Sa i përket natyrës individuale, femra është me të meta dhe e shëmtuar, për arsye se forca aktive në forcën e mashkullit synon ta krijojë një ngjashmëri perfekte në gjininë mashkullore, gjersa krijini i femrës vjen nga të metat në forcë ose nga ndonjë paaftësi materiale ose, madje, nga ndonjë ndikim i jashtëm.”

Në fund, as reformatori i mirënjohur Martin Luteri nuk ka mundur të shikojë kurrfarë dobie nga femra përveç lindjes së një numri sa më të madh të fëmijëve, pa marrë parasysh pasojat negative. *“Nëse lodhen prej kësaj ose nëse edhe vdesin, kjo nuk është me rëndësi. Le të vdesin gjatë lindjes, për këtë edhe ekzistojnë.”*

Sërisht nga fillimi, të gjitha femrat fyhen për shkak të tablos mbi Evën mashtruese, falë rrefimit nga libri i kriji-mit.

Nëse tani i kushtojmë vëmendje asaj se çka thotë Kur'ani në lidhje me femrën, shpejt do të kuptojmë se koncepti islam i femrës ndryshon në mënyrë radikale nga tradita hebrejo-krishtere. Por, le ta thotë vetë Kur'ani:

“Muslimanëve dhe muslimaneve, besimtarëve dhe besimtareve, meshkujve të vërtetshëm dhe femrave të vërtetshme, meshkujve të durueshëm dhe femrave të durueshme, meshkujve të përnulur dhe femrave të përnulura, meshkujve që japin zekat dhe femrave që japin zekat, meshkujve që agjërojnë dhe femrave që agjërojnë, meshkujt të cilët kujdesen për vendet e tyre të trupit dhe femrave të cilat kujdesen për vendet e tyre të trupit, meshkujt të cilët e përmendin shpesh Allahun dhe femrave të cilat e përmendin shpesh Allahun. Allahu, më të vërtetë, për të gjithë këto ka përgatitur falje të mëkateve dhe shpërblim të madh.” (33:35)

“Kush kryen veprë të keqe, do të dënohet për shkak të saj, ndërsa kush kryen veprë të mirë - qoftë mashkull apo femër, e është besimtar, në xhenet do të shkojë, në të do të ketë gjithçka me begatinë e pabesap.” (40:40)

“Aij që e krijon një veprë të mirë, qoftë mashkull apo femër, e është besimtar, ne do t'i japim të jetojë një jetë të mirë edhe, në të vërtetë, do t'i shpërblejmë e shpërblim më të mirë seç e kanë merituar.” (16:97)

Është e evidente se pikëpamja kur'anore ndaj femrës nuk është i ndryshëm nga ai i mashkullit. Edhe njëri edhe tjetri janë krijesa të

Allahut, qëllimi i të cilëve në këtë botë është ta madhërojnë Zotin e tyre, të kryejnë vepra të mira dhe t'i ikin së keqës, andaj bashkarisht do të përgjigjen për këtë. Kur'ani kurrë nuk e përmend femrën si portë të djallit ose si tradhtare sipas natyrës së saj. Kur'ani, gjithashtu kurrë nuk e përmend se njeriu është krijuar sipas pamjes së Zotit, të gjithë meshkujt dhe të gjitha femrat janë krijesa të tij dhe kjo është e tëra. Në bazë të Kur'anit, roli i femrës në tokë nuk është i kufizuar vetëm në lindjen e fëmijës. Prej saj kërkohet të kryejë aq vepra të mira sa kërkohet edhe prej mashkullit. Kur'ani askund nuk përmend se kurrë nuk ka ekzistuar një femër e ndershme, përkundrazi, ai i urdhëron të gjithë besimtarët, si femrat ashtu edhe meshkujt, që ta pasojnë shembullin e femrave ideale siç janë Mejremja, dhe gruaja e Faraonit (Asija) (Kur'an, 66:11 - 13).

BIJAT E TURPIT

Në realitet, dallimi midis qëndrimit kur'anor dhe atij biblik në lidhje me gjininë femrore fillon që nga lindja e fëmijës femër. Për shembull, Bibla pohon se periudha e papastërtisë rituale të femrat është dyfish më e gjatë nëse lind femër sesa mashkull (Ligji levitian, 12:2 - 5). Bibla katolike në mënyrë eksplicite pohon: *“Lindja e vajzës është humbje.”* (Sirah, 22:3)

Përkundër këtij deklarami shokant, fëmijët meshkuj priten me nderim të madh, *“Njeriu i cili e edukon të birin e vet, do të meritojë zëlinë e armiqve të tij.”* (Sirah, 30:3)

Vajza konsiderohet si varrë e dhimbshme, burim potencial i trupit për prindin. “Vajza jote është kokëforte. Shiko mirë që të mos shkakoje përqeshjen nga armiqtë e tu, që mos të të bëjë objekt talljesh, që mos të të bëjë objekt shpifjesh dhe të turpërojë publikisht.” (Sirah, 42:11).

Po kjo ide e njëjtë e raportit ndaj fëmijëve, vajza si burim i turpit, i ka nxituar arabët paganë para ardhjes së Islamit që t'i mbysin fëmijët femra. Kur'ani e ka gjykuar ashpër këtë praktikë të neveritshme,

“Dhe kur ndonjërit prej tyre i lajmëroni se i ka lindur vajzë, fytyra i nxihet dhe ai bëhet i pikelluar, fshihet prej njerëzve për shkak të së keqes e cila iu kumtua: A ta mbajë kështu i përbuzur apo ta fusë në dhe të gjallë? Sa keq gjykojnë ata!” (16:58 - 59)

Duhet të theksojmë se ky zakon i keq kurrë nuk do të kishte pushuar së aplikuari në Arabi, po të mos ishte fuqia e fjalëve të ashpra të Kur'anit, në mes të të cilave gjykohej ky zakon (Kur'an, 16:59, 43:17, 81:8 - 9) Aq më tepër, Kur'ani nuk bën dallim midis fëmijës femër dhe fëmijës mashkull. Për dallim nga Bibla, Kur'ani lindjen e vajzës e konsideron si shpërblim dhe mëshirë nga Zoti, sikurse edhe lindjen e dja-lit. Kur'ani madje shpërblen lindjen e vajzës, atë e përmend në vend të pare: *“Vetëm i Allahut është pushteti në qiiej dhe në tokë. Ai krijon ç'të dojë. Ai i fal fëmijë femër atij që do, e fëmijë mashkull atij që do.” (42:49).*

ARSIMIMI I FEMRËS

Dallimi midis konceptit biblik dhe kur'anor mbi femrën nuk është i kufizuar vetëm në vajzat e posalindura, ai shkon shumë më larg. T'i krahasojmë qëndrimet e tyre në lidhje me gruan e cila dëshiron ta mësojë religjionin e vet.

Zemra e Judaizmit është Tora, ligji, por sipas Talmudit, *“Femrat janë të përjashtuara nga mësimi i Torës”*. Në shekullin e parë të erës së krishterë rabini Elijezer ka deklaruar: *“Nëse një njeri ia mëson vajzës së vet Torën, kjo do të jetë sikur t'ia ketë mësuar prostitucionin.”* Qëndrimi i shën Palit në Dhjatën e Re nuk është aspak më i butë: *“Si në të gjitha kishat e të shenjtëve, femrat të heshtin në kisha, ngase atyre nuk u është lejuar të flasin, por të nënshtrohen, siç urdhëron edhe ligji. Nëse dëshirojnë të mësojnë diçka, le t'i pyesin burrat e tyre në shtëpi, ngase është e pabijshme për gruan të flasë në kishë.”* (Letra e Parë e Korintasve, 14:34 - 35.) Si mund gruaja të mësojë, nëse i ndalohej të flasë? Si mund të zhvillohet intelektualisht, nëse është e detyruar të qëndrojë në gjendje të nënshtimit të plotë? Si mund t'i zgjerohet horizontet e veta, nëse i vetmi burim i informacionit është burri në shtëpi?

Nëse jemi të drejtë, do të duhet të shtrojmë pyetjen: A ndryshon qëndrimi i Kur'anit sadopak? Një rrëfim i shkruar, i cili përmendet në Kur'an, shkurtimisht e përshkruan pozitën e gruas. Havla ishte një muslimane, burri i të cilës me një rast në gjendje të zemrimit kishte deklaruar, *“Ti je për mua si shpina e nënës sime.”* Arabët paganë këto fjalë i kanë konsideruar si formulë për shkurorëzimin, e cila e ka liruar mashkullin nga çdo obligim bashkëshortor, ndërsa gruas nuk i lejohet të largohet nga shtëpia e burrit ose të martohet sërish. Pasi i kishte dëgjuar këto fjalë nga burri, Havla kishte rënë në situatë të mjerueshme. Prandaj shkoi

drejt te Pejgamberi i Islamit dhe ia tregoi rastin e vet. Pejgamberi i tha se duhet të jetë e durueshme. Ngase, siç dukej, nuk kishte rrugëdalje nga kjo situatë. Havla vazhdoi të diskutojë me Pejgamberin duke synuar ta shpëtojë martesën e vet të luhatur. Së shpejti ndërhyri Kur'ani. Arsyetimi i Havës ishte pranuar. Vendimi hyjnor e hodhi poshtë këtë zakon të padrejtë. Një kaptinë e tërë (sure 58) e Kur'anit, e cila quhet “*El-Muxhadila*”, ose “*Gruaja e cila diskuton*”, i është kushtuar këtij rasti.

“Allahu dëgjoi fjalët e asaj që kishte diskutuar mbi burrin e vet dhe i ankoi Allahut, kurse Allahu e dëgjoi bisedën tuaj të ndërsjelltë ngase Allahu, me të vërtetë, gjithçka dëgjon dhe gjithçka sheh.” (58:1)

Femra, sipas Kur'anit, ka të drejtë të polemizojë me mashkullin, madje edhe me Pejgamberin e Islamit personalisht. Askush nuk ka të drejtë ta detyrojë atë të heshtë. Ajo nuk është e obliguar që t'i drejtohet vetëm burrit, në lidhje me pyetjen e ligjit dhe çështjeve të tjera fetare.

PROSTITUCIONI

Roli i gruas, vendi i saj, të drejtat dhe obligimet në Kur'an janë të ndryshme nga ato që hasen në Bibël. T'i përmendim disa shembuj. Prostitucioni konsiderohet mëkat në shumë religjione. Bibla cakton dënim me vdekje për mashkullin që bë prostitucion (lavirin) dhe për femrën që bën prostitucion (laviren) (Ligji levitian, 20:10). Islami, gjithashtu, me dënim të njëjtë dënon edhe mashkullin që bën prostitucion (lavirin), edhe femrën që merret

me prosti-tucion (laviren) (Kur'an, 24:2). Megjithatë, definicioni kur'-anor i prostitucionit ka shumë dallim prej definicionit biblik. Prostitucioni, sipas Kur'anit, është akti seksual në mes të mashkullit dhe femrës, që nuk janë në marrëdhënie marte-sore. Bibla si prostitucion konsideron vetëm marrëdhënien jash-tëmartesore seksuale të femrës së martuar (Ligji levity-an, 20:10, Ligji i Përtëritur, 22:22, fjalë të urta, 6:20 - 7:27). Marrëdhënia seksuale e mashkullit të martuar, sipas Biblës, nuk është kundërvajtje; përse janë të dyfishta këto standarde morale? Gjykuar sipas Enciklopedisë së Judaizmit, gruaja konsiderohet si pronë e burrit, ndërsa prostitucionin e konsideron si cenim i së drejtës ekskluzive të mashkullit mbi të. Gruaja, si pronë e tij, nuk e kishte këtë të drejtë ndaj bu- rrit. Dhjata e Re merr po atë qëndrim te Mateu, 53:31 - 32, ku i përshkruhet Jezusit të ketë thënë: *“E unë ju them se çdo njeri që e lëshon gruan e vet, pos për shkak të adulterisë (lavirësisë), e detyron të bëjë adultëri (lavirësi), dhe kush martohet me grua të lëshuar bën adultëri (lavirësi).”* Pëse mashkulli që shkurorëzohet nga gruaja e tij dhe martohet me një tjetër nuk është quajtur adulter (lavir)?!

Madje deri në ditët e sotme, në Izrael, nëse mashkulli i martuar ngatërrohet në bashkësi jashtëmartesore me një grua, fëmijët e tij të lindur nga kjo lidhje konsiderohen legjitim. Mirëpo, nëse gruaja e martuar mban lidhje me ndonjë mashkull tjetër, fëmijët e saj me këtë njeri, jo vetëm që nuk janë legjitim, por u ndalohet që edhe të martohen me ndonjë hebre, por me kthimtar ose fëmijë ilegjitim (kopila) të tjerë. Ky ndalim vazhdon edhe te pas-ardhësit

e fëmiës deri në brezin e dhjetë, gjersa turpi të dobësohet.

Nga ana tjetër, Kur'ani gruan askund nuk e konsideron si pronë të burrit. Kur'ani raportin e bashkëshortëve e përshkruan me këto fjalë dhe në këtë mënyrë: *“Dhe një nga argumentet e Tij është ai që për ju, nga lloji i juaj, e krijon femrën, që pranë tyre të qetësoheni, dhe midis jush vendos dashuri dhe mëshirë, këto më të vërtetë, janë mësim për njerëzit që mendojnë.”* (30:21) Ky është koncepti kur'anor i martesës: dashuri, mëshirë dhe paqe, e jo pronësi dhe standarde të dyfishta.

DËSHMIMI

Edhe një qëndrim sipas të cilit Kur'ani dallon nga Bibla është qëndrimi në lidhje me dëshminë e femrës. Është e saktë se Kur'ani ka përcaktuar për besimtarët që në transaksione financiare për dëshmitarë duhen marrë dy meshkuj ose një mashkull e dy femra (Kur'an, 2:282). Megji-thatë, është e saktë gjithashtu se në situatat e tjera Kur'ani e pranon dëshmimin e femrës si të barabartë me dëshmimin e mashkullit. Në realitet, dëshmimi i femrës madje mund edhe të mohojë dëshmimin e mashkullit. *“Nëse mashkulli e akuzon gruan e vet për pabesi, Kur'ani nga ai kërkon që të betohet solemnisht pesë herë si argumentim i fajit të gruas. Nëse gruaja i mohon të gjitha dhe solemnisht betohet pesë herë, nuk konsiderohet fajtoare, por që në të dy rastet martesa prishet.”* (24:6 - 11)

Nga ana tjetër, grave nuk u është lejuar të dëshmojnë në shoqërinë e lashtë hebreje. Gratë në Izraelin e sotëm nuk mund

të ofrojnë dëshmi për gjyqet rabine, ngase Talmudi thotë: *“Femrat për nga temperamenti janë mendjelehta.”*

Gjithashtu, rabinët e mbështesin pohimin që femrat nuk mund të dëshmojnë duke cituar Krijimin 18:9 - 16, ku përmendet që Sara, gruaja e Abrahamit, kishte gënjyer. Rabinët e shfrytëzojnë këtë incident si argument që femrat nuk mund të jenë në gjendje që të dëshmojnë. Këtu duhet theksuar se rrëfimi i marrë si shkas është prezent edhe në Kur'an, ku theksohet më shumë se vetëm një herë pa kurrfarë paralajmërimi se Sara ka gënjyer. (Kur'an, 11:69 - 74, 51:24 - 30).

Nëse njeriu e akuzon gruan e vet për tradhti, dëshmimi i saj, sipas Biblës, aspak nuk do të merret në shqyrtim (Numrat, 5:11-31). Në gjykim, gruaja ballafaqohet me ritualin kompleks dhe poshtërues, ku do të duhej të dëshmo-nte fajin ose pafajësinë e saj. Nëse dëshmohet se është fajtore pas procesit gjyqësor, do të dënohet me vdekje. Gjithashtu, nëse një njeri martohet me një femër, e pastaj e akuzonë se nuk ka qenë virgjëreshë, dëshmimi i saj nuk do të merret në shqyrtim. Prindërit e saj duhet të sjellin dëshmi për virgjërinë e saj para pushtetit lokal. Nëse prindërit nuk janë në gjendje ta dëshmojnë virgjinitetin e vajzës së tyre, ajo do të gjuhet me gurë deri në vdekje në prag të shtëpisë prindërore. Nëse prindërit do të jenë në gjendje ta dëshmojnë virgjinitetin e saj, burri në atë rast do të ndëshkohet me 100 shekelë argjendi dhe nuk do t'i lejohet të shkurorezohet nga ajo grua përderisa të jetë gjallë (Ligjet e përtëritura, 22:13 - 21). Përse gruaja e gjorë do të duhej të jetojë deri në fund të jetës me njeriun i cili e ka akuzuar

aq rëndë?

E DREJTA E GRUAS PËR TRASHËGIMI

Një nga dallimet më të rëndësishme në mes të Kur'anit dhe Biblës është qëndrimi ndaj së drejtës së femrës për trashëgiminë e pronës së farefisit të vdekur. Sipas Numrave 27:1-11, vejushat dhe motrat nuk mund të trashëgojnë asgjë. Vajzat mund të trashëgojnë vetëm në rast se babai i vdekur nuk ka pasur fëmijë mashkull. Në çdo rast tjetër, bijtë do ta trashëgojnë tërë pasurinë. Te arabët paganë, pa-ra Islamit, e drejta e trashëgimisë ka qenë e kufizuar ekzkluzivisht të farefisi mashkullor. Kur'ani i anuloi këto zakone prapanike dhe u dha tërë farefisit femëror hise të drejtë në trashëgimi. (Kur'an, 4:7, 11, 12, 176).

FATI I KEQ I VEJUSHAVE

Meqë Dhjata e Vjetër femrës nuk i ka pranuar kurrëfarë të drejte për trashëgimi, vejushat kanë qenë ndër pjesëtarët më të pambrojtura të popullatës hebreje. Farefisi mashkullor që e trashëgonte pronën e burrit të saj të vdek-ur, duhet ta mbanin vejushën nga kjo pronë. Megjithatë, vejushat nuk kishin kurrëfarë mënyre për ta realizuar këtë të drejtë, andaj kryesisht jetonin nga lëmosha e të tjerëve. Për këtë arsye, vejushat kanë qenë ndër shtresat më të ulëta të shoqërisë. Në Izraelin e lashtë, të ishe vejushë është konsideruar si simbol i poshtërimit të madh (Izaija,

54:4). Mirëpo, fati tragjik i vejushave në traditën biblike ka shkuar madje edhe më tej se largimi nga trashëgimia e pronës së burrit të vdekur.

Në bazë të librit Krijimi 38, vejusha pa fëmijë ishte e detyruar të martohej me vëllain e burrit, madje edhe nëse ai tanimë ishte i martuar, që ai mund t'i sigurojë trashëgimtarë vëllait të vdekur, duke mundësuar që emri i tij të mos shuhet. Për këtë martesë nuk ishte i nevojshëm pëlqimi i vejushës. Vejusha konsiderohet si pjesë e pronës së burrit të vdekur, funksioni i së cilës ishte që t'i sigurojë burrit trashëgimtarë. Ky ligj biblik praktikohet akoma në Izraelin e sotëm.

Arabët paganë, para ardhjes së Islamit, kishin zakone të ngjashme. Vejusha është konsideruar si pjesë e pronës së burrit që duhet ta trashëgojë trashëgimtari mashkull dhe zakonisht e martonin me djalin më të madh të njeriut të vdekur me ndonjë grua tjetër. Kur'ani e ka gjykuar dhe e ka ndaluar këtë zakon poshtërues (Kur'an, 4:22).

Vejushat dhe gratë e ndara në traditën biblike kanë qenë aq të poshtëruara, saqë prifti kryesor nuk ka mundur të martohet me grua të ve, të lëshuar ose prostitutë (Ligji levitian, 21:13). Në Izraelin e sotëm, pasardhësit e kastës së Koenit (këta janë priftërinjtë e lartë në ditët e Tempullit), nuk mund të martohen me grua të lëshuar, të ve ose prostitutë. Në të drejtën hebreje, gruaja e cila i ka humbur tre burra, e të gjithë kanë vdekur me vdekje të natyrshme, konsiderohet fatale dhe i ndalohet të

martohet sërish. Nga ana tjetër, Kur'ani nuk i pranon as kastat as personat fatalë. Vejushat dhe gratë e ndara kanë liri të martohen me kë të dëshirojnë. Në Kur'an nuk ekziston turp për gratë e ndara, as për vejushat.

POLIGAMIA

Tani t'i qasemi çështjes tejet të rëndësishme të poligamisë. Përkundrazi, Dhjata e Vjetër dhe shkrimet e rabinëve shpesh e argumentojnë legalitetin e poligamisë. Për mbretin Solomon thuhet se ka pasur shtatëqind gra dhe treqind konkubina (Libri i Parë i Mbretërve, 11:3). Gjithashtu, mbreti David thuhet se ka pasur shumë gra dhe konkubina (Libri i Dytë i Samuidit, 5:13). Dhjata e Vjetër i ka disa dispozita në lidhje me atë se si duhet të ndajë pronën njeriu i cili ka fëmijë me gra të ndryshme (Ligjet e përtëritura, 22:7). Kufizimi i vetëm të poligamia është ndalimi i martesës me motrën e gruas si rivale të gruas (Ligji levitian, 18:18). Talmudi preferon më së shumti katër gra. Hebrejtë evropianë kanë vazhduar ta praktikojnë poligaminë deri në shekullin XVI. Hebrejtë orientale rregullisht e kanë praktikuar poligaminë derisa arritën në Izrael, kur ajo u ndalua sipas ligjit civil. Megjithatë, sipas ligjit religjioz, i cili në rastet e tilla ka përparësi ndaj ligjit civil, poligamia është e lejuar.

Si qëndron puna me Dhjatën e Re? Gjykuar sipas atit Eugen Hillman në librin e tij “Shqyrtimi i sërishëm i poligamisë”: “Askund në Dhjatën e Re nuk ekziston ndonjë urdhër eksplicit

që martesë të jetë monogame, ose ndonjë urdhër eksplisit i cili e ndalon poligaminë.”

Në anën tjetër, Jezusi nuk ka folur kundër poligamisë, ndonëse hebretjtë e komunitetit të tij e praktikonin. Ati Hillman ka theksuar faktin se kisha romake e ka ndaluar poligaminë për t’iu përshtatur kulturës greko-romake, e cila parashih vetëm një grua legjitime, gjersa i toleronte konkubinatin dhe prostitucionin. Ai e citonë shën Augustinin: *“Tani në kohën tonë, më të vërtetë, duke mos u mbuar zakonet romake, nuk është më e lejuar të merret edhe një grua e dytë.”* Kisha afrikane dhe krishterët afrikanë shpesh i përkujtojnë vëllezërit e tyre evropianë se ndalesa kishtarë e poligamisë është traditë kulturore dhe jo mësim autentik i krishterë.

Kur'ani gjithashtu e lejon poligaminë, por jo pa kufizim:

“Nëse keni frikë se ndaj bonjakëve nuk do të jeni të drejtë, atëherë martohuni me ato gra me të cilat u është lejuar, me dy, me tri dhe me katër. E nëse frikoheni se nuk do të jeni të drejtë, atëherë vetëm me një.” (4:3)

Përkundër Biblës, Kur'ani e ka kufizuar numrin maksimal të grave në katër, me kusht të prerë që të gjitha të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të drejtë. Me këtë nuk duhet kuptuar se Kur'ani i nxit besimtarët që ta praktikojnë poligaminë ose që poligamia është konsideruar ideale. Me fjalë të tjera, Kur'ani e “toreron” ose “lejon” poligaminë, jo më shumë se kjo, por përse? Përse është lejuar ose toleruar poligamia në Kur'an? Përgjigja është e thjeshtë, ekzistojnë vende dhe kohë në të cilat disa shkaqe e bëjnë të domosdoshme poligaminë. Islami, si religjion universal, i përshtatshëm për të gjitha vendet dhe kohët, nuk ka mundur

t'i injorojë këto shkaqe detyruese.

Në shumë shoqëri njerëzore numri i grave e tejkalon numrin e meshkujve. Në Shtetet e Bashkuara ka mbi tetë milionë femra më shumë se meshkuj. Në ndonjë vend, siç është Guineja, në çdo njëqind meshkuj gjenden njëqind e njëzet e dy femra. Në Tanzani ka 95.1 meshkuj në njëqind femra. Çdo të duhej të bënte shoqëria me këto dallime dis-proporcionale midis gjinive? Ekzistojnë shumë zgjidhje; disa do të preferonin celibatin (beqarinë), disa më me dëshirë do të praktikonin mbytjen e fëmijëve femra (gjë që ndodh edhe sot në disa shoqëri!). Disa do të supozojnë se rrugëdalje mund të jetë lejimi i çdo lloji të dekadencës: prostitucioni, homosek- sualiteti, adulteria.

Shoqëritë e tjera, siç janë shumica e vendeve afrikane të kohës sonë, rrugëdaljen më të mirë e shohin te poligamia si institucion të respektuar shoqëror. Gjëja që shpesh keqku-ptohe në Perëndim është se femrat në kulturat e tjera poligaminë nuk e shikojnë si shenjë të keqtrajtimit edhe poshtërimit të femrës. Për shembull, shumë vajza afrikane, qofshin muslimane apo të krishtera, më shumë do të dëshirojnë të martohen me një njëri të martuar, i cili tanimë është dëshmuar se mund të jetë bashkëshort i mirë. Shumë gra afrikane i nxisin burrat e tyre të martohen edhe njëherë për të mos qenë të vetmuara. Problemi është që dallimi në numër midis femrave dhe meshkujve më të vërtetë bëhet problematik në kohën e ndonjë lufte. Fiset indiane të Amerikës Veriore kanë pësuar dallime aq të mëdha pas luftimeve dhe disfatave të shumta kundër të bardhëve. Gratë e këtyre fiseve, të

cilat në esencë kanë gëzuar status tjetër të lartë, e kanë pranuar poligaminë si mbrojtje më e mirë nga zhytja në vepra të pahijshme. Ardhasakët evropianë, duke mos ofruar kurrfarë alternative tjetër, poligaminë tek indianët e kanë gjykuar si akt jocivilizues.

Pas Luftës së Dytë Botërore, në Gjermani ka pasur 7.300.000 femra më tepër se meshkuj, 3.3 milionë kanë qenë vejusha. Kishte vetëm njëqind meshkuj të moshës prej njëzet deri në 30 vjeç në çdo njëqind e shtatëdhjet femra të po kësaj moshe. Shumë nga këto femra kishin nevojë për mashkull, jo vetëm si partner seksual, por edhe si personi i cili do të siguronte mjete për jetë në kohën e varfërisë dhe mjerimit të paparë. Ushtarët e disa ushtrive aleate e shfry-tëzonin lëngatën e këtyre femrave. Shumë vajza të reja dhe vejusha mbanin lidhje seksuale me përfaqësuesit e forcave okupuese. Shumë ushtarë amerikanë e britanikë këtë këna-qësi e paguanin me cigare, çokolata, bukë... Fëmijët ishin të lumtur për shkak të dhuratave që i sillnin të huajt. Një djalosh dhjetëvjeçar, i cili kishte dëgjuar një fëmijë tjetër për dhuratat dhe ushqimin që i sillnin të huajt, me gjithë zemër dëshironte një anglez për nënën e vet, në mënyrë që ajo të mos vuante më për ushqim.

Këtu duhet ta pyesim veten, ç'është më e ndershme? Të jesh gruaja e dytë e respektuar dhe e pranuar në pikëpa-mjen e indianëve, apo prostitute e njëmendtë në aspektin e aleatëve të "civilizuar"? Me fjalë të tjera, ç'është më e ndershme për femrën, receta kur'anore opo teologjia e bazu-ar në kulturën e perandorisë romake?

Botë e sotme posedon më shumë armë për shkatërrimin masiv se asnjëherë më parë, kështu që kisha evropiane do të jetë e detyruar që herët ose vonë ta pranojë poligaminë si rrugëdalje të vetme. Ati Hillman këtë fakt e ka përpunuar thelbësisht dhe e ka pranuar me arsyetim. *“Mund të supozojmë se këto teknika nukleare, biologjike dhe kimike do të shkaktojnë një dallim drastik midis gjinive, dhe poligamia do të paraqitet si mënyrë e domosdoshme e ekzistencës... Atëherë, në kundërshtim me zakonet dhe ligjin e mëparshëm, do të shtohet nevoja natyrore dhe morale për poligaminë. Në këtë situatë, teologët dhe paria kishtarë shpejt do të gjejë shkaqe të forta dhe vargje biblike që do ta miratonin konceptin e ri të martesës.”*

Duhet theksuar me këtë rast se poligamia në Islam është akt i pranishëm dhe i përbashkët. Asnjëri nuk mund ta detyrojë gruan të lidhë kurorë me ndonjë njeri të martuar. Nga ana tjetër, Bibla nganjëherë i qaset poligamisë së dhunshme. Vejusha pa fëmijë është e detyruar të martohet me vëllanë e burrit, edhe nëse ai tanimë është i martuar, pa marrë parasysh pëlqimin e saj (Krijimi 38).

Duhet thënë se praktikimi i poligamisë në shumë komunitete muslimane sot paraqet raretet, meqë dallimi i numrit midis meshkujve dhe femrave është tejet i parëndësishëm. Mund të thuhet me siguri se përqindja e martesave poligamike në botën muslimane është shumë më e vogël se përqindja e aferave jashtëmartesore në Perëndim, me fjalë të tjera, meshkujt në botën muslimane janë shumë më strikt në monogami se meshkujt në botën perëndimore.

TË MBULUARIT ME SHAMI

Në fund duhet të sqarojmë atë që në Perëndim konside-rohet si simboli më i madh i shtypjes dhe i nëpërkëmbjes së femrës, e kjo është të mbuluarit, ose shamia mbi flokë. A është e vërtetë që në traditën hebrejo-krishtere nuk ekzi-ston mbulesa? Ta verifikojmë.

Sipas fjalëve të rabinut dr. Menahem M. Brajer, profesor i letërsisë biblike në Universitetin e Jeshivit, nga libri i tij *“Femra hebreje në letërsinë biblike”*, gjithnjë ka qenë zakon që gratë hebreje të dalin në opinion me kokë të mbuluar, nganjëherë madje duke e lënë vetëm një sy të zbuluar. Ai i citon disa rabinë të lashtë, *“Nuk u ka hije vajzave të Izraelit që të dalin ndër njerëz pa e mbuluar kokën.”*

Qoftë mallkuar burri i cili lejon që të duken flokët e gruas së tij... gruaja e cila i zbulon flokët e saj si stoli, sjell mjerim.”

Ligji rabinian e ndalon leximin e bekimit dhe lutjeve në prani të grave me kokë të zbuluar, meqë të zbulimi i flokëve të gruas është konsideruar si *“lakuriqësi”*. Doktor Brajeri gjithashtu përmend se *“gjatë perindhës tanaite, lëshimi i mbulimit të kokës nga ana e grave hebreje është konside-ruar si sulm ndaj modestisë së tyre. Kur gruaja e zbulon kokën, mund të ndëshkohet për këtë kundërvajtje me katër-qind zuzuma.”* Doktor Brajer gjithashtu e përmend se mbule-sa e gruas hebreje gjithmonë është konsideruar si simbol i modestisë. Nganjëherë e simbolizon dallimin në status dhe luksuzitet, e jo modesti. Zari ka qenë personifikim i nderit dhe i superioritetit të grave fisnike. Ai

gjithashtu, ka preze-ntuar edhe paarritshmërinë e femrës, meqë ajo ka qenë pronë e dedikuar për burrin e vet. Në Dhjatën e Vjetër qartë është bërë me dije se zbulimi i kokës te femra paraqet turp të madh dhe për këtë arsye priftërinjtë kanë qenë të detyruar ta zbulojnë prostitutën e dyshimtë me anë të gjykimit (Numrat, 5:16 - 18).

Si qëndron puna me traditën e krishterë? Dihet se murgeshat e kanë mbuluar kokën me qindra vjet, mirëpo kjo nuk është e tëra. Shën Pali ka deklaruar gjëra tejet interesante mbi mbulesën në Dhjatën e Re, *“Mirëpo dëshiroj ta dini se Krishti është koka e çdonjërit, ndërsa njeriu koka e femrës, ndërsa Zoti është koka e Krishtit. Çdo njeri, i cili i lutet Zotit ose predikon me kokë të mbuluar, e turpëron kokën e vet. Ndërsa çdo grua, e cila predikon ose i lutet Zotit kokë-zbuluar, e turpëron kokën e vet, ngase është njësoj sikur të jetë e qethur. Nëse gruaja nuk mbulohet, atëherë mundet lirisht edhe të qethet. Mashkulli ndërkaq nuk duhet ta mbulojë kokën, meqë është pamje dhe famë e Zotit, ndër-kaq gruaja është fama e mashkullit. Ngase nuk është krijuar mashkulli prej femrës, por femra prej mashkullit. Dhe nuk është krijuar mashkulli për shkak të femrës, por femra për shkak të mashkullit. Prandaj gruaja duhet ta ketë shenjën e pushtetit të burrit në kokë - për shkak të engjëjve.”* (Letra e Parë Korintasve, 11:3 - 10)

Shën Pali na ofron një bazë logjike për mbulimin e femrës, e kjo është shenja e autoritetit të burrit, ngase njeriu është krijuar sipas pamjes së Zotit, mbi gruan e cila është krijuar nga mashkulli dhe për mashkullin. Shën Tertuliani në trajtesën e tij të njohur, *“Mbi të mbuluarit e vajzave”* shkruan: *“O femra të reja, mbani shaminë*

në rru-gë, mbajeni në kishë, mbajeni kur ndodheni në mesin e të huajve, mbajeni kur ndodheni në mesin e vëllëzërve tuaj..” Në mesin e ligjeve kanunore të kishës së sotme katolike ekziston edhe ligji i cili urdhëron që femrat ta mbulojnë kokën në kisha. Disa dominime kishtare, si Amishët dhe Menonitët, mbulesën e kokës së femrës e kanë ruajtur deri më sot. Shkaku i mbajtjes së shamisë, që e ofron paria e tyre kishtare, është *“Simbol i nënshtrimit të gruas para burrit dhe Zotit”*. Logjika e njëjtë është praktikuar edhe në Dhjatën e Re nga ana e shën Palit.

Nga të gjitha argumentet e theksuara është evidente se mbulimin e kokës nuk e ka shpikur Islami, ai vetëm e ka vërtetuar. Kur'ani i urdhëron edhe besimtarët dhe besimtare të që ta ulin shikimin dhe ta ruajnë nderin e tyre, prandaj i urdhëron besimtareve ta lëshojnë shaminë e tyre derisa të mbulojnë qafën dhe krahorin (Kur'an, 24:30 - 31)

“Dhe thuaju besimtareve që ta lëshojnë shikimin e vet dhe të kujdesën për vendet e tyre të turpërta, dhe të mos i zbulojnë stolitë e tyre pas atyre që edhe ashtu janë të dukshme, dhe t'i lëshojnë shaminë e tyre në krabëror...”

Kur'ani tregon qartë se mbulimi i kokës (shamia) është pjesë tejet e rëndësishme e planit të dedikuar për qëllime modestie, por përse të modestisë? Kur'ani është i qartë: *“O Pejgamber, i thuaj grave të tua dhe bijave të tua, edhe grave të besimtarëve që t'i lëshojnë mbulesat e tyre mbi trupin. Kështu që të njihen më mirë dhe të mos ofendo-ben.”* (33:59). Kjo është çështja, modestia është përcaktuar që t'i mbrojnë femrat nga ofendimet; ose thënë më shkurtë modestia është mbrojtje.

Prandaj, qëllimi i vetëm i shamisë në Islam është mbrojtja. Shamia islame, për dallim nga ajo e krishterë, nuk është shenjë e pushtetit të mashkullit mbi femrën, as është shenjë e nënshtimit të femrës ndaj mashkullit. Shembulli islam, në dallim nga ai i traditës hebreje, nuk është simbol i luksit dhe dallimit të disa femrave të martuara me prejardhje fisnike. Mbulesa islame është vetëm shenjë e modestisë me të vetmin qëllim që t'i mbrojë femrat në tërësi. Filozofia islame përbëhet nga ajo që më mirë është të jesh në të sigurtë se pastaj të pendohesh. Në esencë, Kur'ani kujdeset aq mirë që ta mbrojë trupin e femrës dhe reputacionin e saj, sa ai që merr guxim ta akuzojë femrën rrejshëm për imoral, do të dënohet ashpër: *“Ata të cilët i akuzojnë gratë e ndershme, e kjo nuk dëshmohet me katër dëshmitarë, i rrihni me nga tetëdhjetë goditje të kamxhikut dhe kurrë më mos e pranoni dëshminë e tyre: të tillë janë njerëz të pandershëm.”* (24:4)

Krahasoni këtë qëndrim tejet të prerë të Kur'anit me ndëshkimin tejet indulgjent për mbulim në Bibël, “Nëse mashkulli i takon një vajze të virgjër, e cila nuk i është besuar askujt për martesë, dhe e dhunon, e pastaj kjo gjë zbulohet, duhet t'i paguajë babait të saj pesëdhjetë shekela të argjendit. Ai duhet të martohet me atë vajzë, ngase e ka marrë me dhunë. Ai nuk mund të shkurorëzohet deri sa të jetë gjallë.” Këtu njeriu duhet ta pyesë veten: Kë kemi dënuar me këtë rast? Njeriu që është detyruar të paguajë dënim për shkak të dhunës, apo vajzën, e cila është e detyruar që të martohet me njeriun i cili e ka dhunuar dhe të jetojë me të deri në fund të jetës? Pyetja tjetër që do të duhej bërë, është se cili qëndrim e mbron

femrën më shumë, qëndrimi strikt kur'anor apo qëndrimi indulgjent biblik? Disa njerëz, posaçërisht në Perëndim, do ta provojnë ta tallin këtë argument të modestisë për shkak të mbrojtjes. Argumenti i tyre është: duhet përhapur arsimimi, sjellja civilizuese dhe vetëkontrollimi. Na merr mendja se kjo është në rregull, por nuk është e mjaftueshme. Nëse “civilizimi” ofron mbrojtje të mjaftueshme, për ç'arsye atëherë femrat në Amerikën Veriore kanë frikë të enden të vetëm rrugëve të errëta, madje të kalojnë nëpër ndonjë vendparkim të zbrazët? Nëse është zgjidhje “arsimimi”, përse atëherë fakultetet e njohura, siç është i yni, ka shërbimin për përcjelljen e studenteve në kampe? Nëse “vetëkontrollimi” është zgjidhje, përse atëherë çdo ditë dëgjojmë për rastet e keqtrajtimit seksual në vende të punës? Profili i të akuzuarve për keqtrajtim seksual viteve të fundit ka përfshirë edhe oficerët e marinës, drejto-rët, profesorët e universitetit, senatorët, gjykatësit suprem, madje edhe presidentin e Shteteve të Bashkuara të Ameri-kës! Nuk kam mundur t'u besoj syve kur kam lexuar statisti-kat e shtypura në pamfletën e botuar nga dekani i repartit të femrave të Universitetit Mbretëror, të cilat do t'i paraqesim në vazhdim:

“Në Kanada, çdo gjashtë minuta një femër keqtrajtohet seksualisht. Një nga tri femrat në Kanada është keqtrajtuar seksualisht gjatë jetës së saj. Njëres prej katër femrave i kanoset dhunimi ose tentim dhunimi në jetën e saj. Një në tetë femra sulmohet me motivacion seksual gjatë shkollimit të mesëm ose fakultetit. Hulumtimet kanë dëshmuar se më se gjashtëdhjetë

përqind e të rinve, të cilët janë në moshën e regjistrimit në fakultet, pranon se do të kryejmë ndonjë sulm seksual sikur të ishin të sigurtë se nuk do të zbulo-hen.”

Ekziston një gabim fundamental në shoqërinë në të cilën jetojmë. Është i nevojshëm një ndryshim radikal në stilin shoqëror të jetës dhe në kulturë. Kemi nevojë të jashtëzakonshme për kulturën e modestisë, në veshmbathje dhe fjalë, në sjelljen e femrave dhe të meshkujve. Në të kundërtën, statistikisht e zeza do të keqësohen gjithnjë e më shumë nga dita në ditë dhe fatkeqësisht femrat do të jenë të vetmet që do ta paguajnë çmimin. Për këtë arsye, shoqëria, siç është ajo franceze, e cila i largon femrat e reja nga shkolla për shkak të veshjes së tyre modeste, në fund do t'i sjellë dëm vetvetes.